



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 220 Akti

Nr. 299 Vendimi
Tiranë, më 17.9.2020

V E N D I M

Trupi gjykues nr. 4 i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Pamela Qirko	Kryesuese
Valbona Sanxhaktari	Relatore
Lulzim Hamitaj	Anëtar

asistuar nga sekretare gjyqësore, znj. Orjanda Lici, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Tonci Petkovic, në datën 14.9.2020, ora 11:00, zhvilloi në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, seancën dëgjimore mbi çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Znj. Fjoralba Prifti**, me detyrë gjyqtare në Gjykatën Administrative të Apelit.

OBJEKTI: **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

BAZA LIGJORE: **Neni 179/b i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenet “A”, “Ç”, “D”, “DH”, “E” dhe “Ë” të Aneksit të Kushtetutës;**

Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

Ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

Ligji nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar.

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoi rekomandimet e relatores së çështjes, znj. Valbona Sanxhaktari, dëgjoi shpjegimet e subjektit të rivlerësimit dhe analizoi provat shkresore të paraqitura në vijim të rezultateve të hetimit dhe në seancë dëgjimore, si dhe shqyrtoi dhe analizoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Znj. Fjoralba Prifti është subjekt i rivlerësimit për shkak të pozicionit si gjyqtare në Gjykatën Administrative të Apelit. Bazuar në pikën 4, të nenit 4 dhe në pikën 2, të nenit 14, të ligjit nr. 84/2016, si dhe në rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit”, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim Komisioni) ka hedhur shortin në datën 15.11.2018, nga i cili rezultoi se subjekti i rivlerësimit i është nënshtruar procesit të rivlerësimit nga trupi gjykues nr. 4, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

2. Me vendimin e trupit gjykues, datë 21.11.2018, është vendosur kryesuese komisionere Pamela Qirko dhe është deklaruar lidhur me konfliktin e interesit nga të gjithë anëtarët e trupit gjykues.

3. Subjekti i rivlerësimit është njoftuar për përbërjen e trupit gjykues, që do të kryente procesin e rivlerësimit dhe ka deklaruar se nuk ka konflikt interesi me pjesëtarët e tij.

4. Nga relatori janë administruar raportet e vlerësimit, të hartuara nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar dhe Këshilli i Lartë Gjyqësor. Janë administruar të gjitha denoncimet e ardhura për subjektin e rivlerësimit Fjoralba Prifti.

5. Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu hetimin dhe vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë:

- a) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja dhe provat e dorëzuara nga subjekti pranë këtij institucioni në “deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar *Vetting*”;
- b) provat e dorëzuara nga subjekti në ILDKPKI së bashku me deklaratimet periodike vjetore, të kryera ndër vite;
- c) raportin e dorëzuar në Komision nga DSIK-ja, së bashku me dokumentacionin shoqërues;
- d) informacion të përditësuar lidhur me subjektin e rivlerësimit nga institucionet ligjzbatuese;
- e) raportin e dorëzuar në Komision nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, së bashku me materialin shoqërues;
- f) dokumente shpresore nga organet publike dhe private, në përputhje me nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016;
- g) deklaratimet nga subjekti i rivlerësimit nëpërmjet komunikimit elektronik;
- h) denoncimet nga publiku.

6. Në datën 5.8.2020, trupi gjykues vendosi: (i) të përfundojë hetimin kryesisht për subjektin e rivlerësimit, znj. Fjoralba Prifti, bazuar në të tri kriteret e vlerësimit: vlerësimin e pasurisë, kontrollin e figurës dhe vlerësimin profesional; (ii) të njoftojë subjektin e rivlerësimit mbi rezultatet e hetimit, si dhe ta ftojë për t’u njohur me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 84/2016, si dhe me nenet 45 - 47 dhe 35 - 40 të Kodit të Procedurave Administrative; (iii) të njoftojë subjektin e rivlerësimit mbi të drejtat që gëzon nga ligji për të kërkuar marrjen e provave të tjera ose thirrjen e dëshmitarit, si edhe afatin brenda të cilit mund t’i ushtrojë këto të drejta dhe të paraqesë parashtrimet e saj.

7. Subjekti i rivlerësimit u njoh me dosjen dhe mori një kopje të saj, fakt të cilin e konfirmoi edhe në seancën dëgjimore. Subjekti i rivlerësimit paraqiti shpjegime lidhur me rezultatet e hetimit të Komisionit dhe dokumentacion ligjor provues.

8. Në përputhje me nenin 55 të ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues ftoi subjektin e rivlerësimit, znj. Fjoralba Prifti, në seancë dëgjimore, në datën 14.9.2020, ora 11:00, në Pallatin e Koncerteve, Tiranë, salla B, kati 0.

9. Në seancën dëgjimore subjekti i rivlerësimit u paraqit personalisht. Seanca dëgjimore u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, në datën 14.9.2020, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar z. Tonci Petkovic. Në përfundim të seancës dëgjimore znj. Fjoralba Prifti kërkoi konfirmimin në detyrë.

10. Trupi gjyqës përfundoi seancën dëgjimore dhe, për rrjedhojë, edhe procesin e rivlerësimit për znj. Fjoralba Prifti në seancën e datës 17.9.2020, në të cilën subjekti ishte e pranishme.

A. VLERËSIMI I PASURISË

11. Subjekti i deklarimit znj. Fjoralba Prifti (Qinami) ka dorëzuar deklaratën e pasurisë për procesin e rivlerësimit në ILDKPKI së bashku me dokumentacionin provues. Kjo deklaratë, në bazë të nenit 33¹ të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, iu nënshtrua hetimit administrativ nga ILDKPKI-ja.

12. Në përfundim të hetimit administrativ, bazuar në nenin 33/5/a të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ILDKPKI-ja në raportin e saj ka konkluduar se:

- *deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin;*
- *nuk ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
- *ka kryer fshehje të pasurisë;*
- *ka kryer deklarim të rremë;*
- *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

13. Deklarata e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, znj. Fjoralba Prifti, iu nënshtrua një hetimi administrativ të thelluar nga Komisioni², i cili konsiston në verifikimin e vërtetësisë dhe saktësisë së deklarimeve të bëra nga subjekti i rivlerësimit në lidhje me gjendjen pasurore, burimet e krijimit, të ardhurat, shpenzimet, nëse ka konflikt interesi, fshehje të pasurisë apo deklarim të rremë, si dhe përcaktimin e gjendjes së fakteve dhe rrethanave që kanë lidhje me çështjen.

14. Në deklaratën e pasurisë *Vetting*, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar:

1. Apartament banimi me sip. 121.29 m², me nr. pasurie ***, në vlerën 83,500 (tetëdhjetë e tre mijë e pesëqind) euro, të likuiduara jashtë zyrës së noterisë dhe garazh me sip. 17 m², me nr. pasurie ***, në vlerën 12,000 (dymbëdhjetë mijë) euro, të likuiduara jashtë zyrës së noterisë. Kjo pasuri është krijuar para martesë nga bashkëshorti me Kontratën e Sipërmarrjes datë 15.3.2004, por kalimi i pronësisë është kryer gjatë martesës me Kontratën e Shitblerjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 6.7.2013, regjistruar në ZVRPP Tiranë, më 1.10.2013.

1.1 Burimet e krijimit, për pasuritë e mësipërme të deklaruara nga subjekti, janë: (i) kursimet e bashkëshortit, të siguruara nga puna ndër vite; (ii) hua në shumën 30,000 (tridhjetë mijë) euro, marrë nga z. S. P. (babai i bashkëshortit), e dokumentuar sipas Kontratës së Huas³ datë 14.2.2006.

1.2 Subjekti ka përcjellë Kontratën e Sipërmarrjes së datës 15.3.2004, me palë porositëse z. E. P. dhe palë sipërmarrëse shoqërinë “****” sh. a. Në kontratë përshkruhet apartament me sip. totale 132.8 m² dhe garazh, ku vlera e apartamentit është 83,500 (tetëdhjetë e tre mijë e pesëqind) euro dhe vlera e garazhit 12,000 (dymbëdhjetë mijë) euro.

1.3 Gjatë hetimit administrativ, subjekti⁴ ka deklaruar mënyrën e shlyerjes së kësteve për këto pasuri para martesë, të cilat janë prezantuar në tabelën, si vijon:

¹“Procedura e vlerësimit të pasurisë 1. ILDKPKI-ja, bazuar në deklaratimet e pasurive, zhvillon një procedurë të plotë kontrolli në përputhje me ligjin, ‘Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, detyrimeve financiare të personave të zgjedhur dhe nëpunësve të caktuar publikë’, ligjin ‘Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike’ si dhe ‘Kodin e Procedurave Administrative’.

²Vendimi nr. 2/2017 i Gjykatës Kushtetuese, “41. Për rrjedhojë, gjykata vlerëson se pretendimi se organet ekzistuese zëvendësojnë organet e reja të rivlerësimit, është i pabazuar. Sipas nenit 179/b, pika 5, të Kushtetutës, rivlerësimi kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, kurse sipas nenit 4/2 të ligjit: “Komisioni dhe Kolegji i Apelit janë institucionet që vendosin për vlerësimin përfundimtar të subjekteve të rivlerësimit”. Pavarësisht formulimit të kësaj dispozite ajo nuk mund të lexohet në mënyrë të shkëputur, por në harmoni me dispozitat e tjera ligjore që përcaktojnë në mënyrë të detajuar kompetencat e organeve të përfshira në proces, si dhe kompetencat që kryen vetë Komisioni i Pavarur i Kualifikimit gjatë këtij procesi.”

³ Shihni Kontratën e Huas nr. *** rep., nr. *** kol., datë 14.2.2006 (dosja e ILDKPKI-së, Aneksi 4/23).

⁴ Përgjigje pyetësorisht, datë 16.12.2019 (pyetja 1).

Data e transaksionit	Vlera e kështit	Mënyra e kryerjes së pagesës sipas deklarimit të subjektit
Kësti I: 15.3.2004	€ 20,000	Mandatpagesë me shoqërinë “****” sh.a.
Kësti II: 5.5.2004	€ 30,000	Me derdhje në bankën “CBG (Emporiki)”, në datën 5.5.2004
Kësti III: 5.1.2005	€ 20,000	Me derdhje në bankën “CBG (Emporiki)”, në datën 5.1.2005
Kësti IV: 4.7.2005	€ 8,500	Me derdhje në bankën “CBG (Emporiki)”, në datën 4.7.2005
Totali	€ 78,500	

1.4 Këto pasuri (apartamenti dhe garazhi) janë deklaruar nga subjekti i rivlerësimit në DPV-në e vitit 2006, vit në të cilin është martuar⁵ (datë 8.2.2006) me bashkëshortin E. P.. Në këtë vit deklarohet detyrimi i mbetur në shumën prej 17,000 (shtatëmbëdhjetë mijë) euro ende i pashlyer ndaj shoqërisë “****” sh.a. dhe detyrimi financiar në hua ndaj z.S. P.⁶ (babai i bashkëshortit), në vlerën prej 30,000 (tridhjetë mijë) euro.

1.5 Komisioni ka hetuar në lidhje me burimin e krijimit të pasurisë, si dhe aftësinë paguese të bashkëshortit të subjektit (para dhe pas martese).

1.6 Sipas dokumentacionit të administruar nga hetimi, lidhur me pagesat, ka rezultuar si vijon:

1.6.1 Kësti I – në vlerën 20,000 (njëzet mijë) euro, paguar më 15.3.2004 me mandatpagese (*cash*) në arkën e shoqërisë “****” sh.a. Subjekti deklaron se të ardhurat e bashkëshortit në këtë periudhë kanë qenë të mbajtura prej tij, kryesisht gjendje *cash* dhe se një pjesë e kursimeve të tij janë mbajtur në bankë, përkatësisht në “FEFAD Bank” dhe “Raiffeisen Bank”:

1) Për kursimet në “FEFAD Bank” (shndërruar në “ProCredit Bank”), subjekti sqaron se bashkëshorti ka pasur llogari prej datës 19.9.2001, në vlerën 5,000 DEM, duke vijuar mbi vlerat e depozituara dhe tërheqjet e tij në këtë bankë: (a) depozitimi i vlerës 2,573 (dy mijë e pesëqind e shtatëdhjetë e tre) euro në datën 13.12.2001, e tërhequr para afatit; (b) depozitimi i vlerës 4,460 (katër mijë e katërqind e gjashtëdhjetë) euro në datën 21.3.2002, e tërhequr para afatit; (c) depozitimi i vlerës 2,509 (dy mijë e pesëqind e nëntë) euro në datën 13.6.2003, e cila është tërhequr (bashkë me interesat e depozitës) në datën 15.3.2004 (data e kështit të parë).

2) Për të ardhurat e mbajtura në kohën e “Bankës së Kursimeve” (shndërruar në “Raiffeisen Bank”), subjekti nuk arriti të siguronte informacion dhe, në vijim, sqaron se bashkëshorti ka tërhequr në “Raiffeisen Bank”, gjatë periudhës 2004 – 2005, vlerën prej 2,706,449 (dy milionë e shtatëqind e gjashtë mijë e katërqind e dyzetë e nëntë) lekë në total.

1.6.2 Nga hetimi⁷ i llogarive bankare të z. E. P. rezultoi se ka pasur depozita në “FEFAD Bank” prej vitit 2001, të cilat maksimumin e vlerës totale të arritur e kanë pasur 4,460 (katër mijë e katërqind e gjashtëdhjetë) euro (datë 15.2.2002). Ndërkohë, në lëvizjet e llogarisë bankare në “ProCredit Bank” rezulton se në datën 15.3.2004, z. E. P. ka mbyllur depozitën e tij në euro dhe ka tërhequr vlerën prej 2,540 (dy mijë e pesëqind e dyzet) euro.

Duket se një pjesë e pagesës së kështit të I-rë është shlyer me likuiditetet në bankë dhe vlera e mbetur prej 15,540 (pesëmbëdhjetë mijë e pesëqind e dyzet) euro, mund të jetë nga kursimet *cash* të tij.

⁵ Shihni certifikatën e martesës datë 14.12.2012, përcjellë me pyetësorin e datës 16.12.2019.

⁶ Z. S. P., në janar të vitit 2005, i ka dhënë hua djalit të tij, E. P., shumën 30,000 (tridhjetë mijë) euro, me kushtin që të likuidohej plotësisht brenda një afati 5-veçar (janar të vitit 2010), pa përcaktuar qëllimin për dhënien e huas.

⁷ Shihni shkresën e ardhur nga “ProCredit Bank”, me nr. *** prot., datë 28.2.2019.

1.6.3 Kësti II – në vlerën 30,000 (tridhjetë mijë) euro është paguar në datën 5.5.2004 me depozitim në bankën “CBG (Emporiki)”. Subjekti deklaroi se kjo pagesë është mbuluar nga z. E. P. nga të ardhurat e deklaruara më sipër. Nga hetimi rezultoi se në bankat e nivelit të dytë, të cilat kanë dhënë informacion për këtë periudhë, nuk ka pasur lëvizje të llogarive bankare të bashkëshortit. Duket se kjo vlerë mund të jetë kursyer *cash* nga bashkëshorti për pagesën e këtij kësti. Përveç vlerave të mësipërme, gjatë hetimit nuk rezultuan të ardhura të tjera apo vlera monetare të bashkëshortit në harkun kohor të pagesës së dy kësteve të para (deri më 5.5.2004).

1.6.4 Kësti III – në vlerën 20,000 (njëzet mijë) euro është paguar më 5.1.2005 me depozitim në bankën “CBG (Emporiki)”. Subjekti deklaroi se kjo pagesë është mbuluar nga z. E. P. nga të ardhurat e deklaruara më sipër. Nga hetimi i Komisionit, në lëvizjet e llogarisë bankare në “Raiffeisen Bank” rezultoi se më 25.11.2004, bashkëshorti i subjektit ka depozituar shumën *cash* prej 1,600,000 (një milion e gjashtëqind mijë) lekësh dhe po në të njëjtën datë ka depozituar edhe shumën prej 2,500 (dy mijë e pesëqind) euro *cash*. Më pas, këto vlera janë tërhequr nga bashkëshorti i subjektit datë 5.1.2005, e cila është edhe data e pagesës së këstit të III-të. Vlera totale e konvertuar⁸ e tërheqjeve të mësipërme nga llogaria e bashkëshortit në datën e pagesës së këstit të III-të është 15,272 (pesëmbëdhjetë mijë e dyqind e shtatëdhjetë e dy) euro.

1.6.5 Nga hetimi duket se një pjesë e pagesës së këstit të III-të është shlyer me likuiditetet në bankë të E. P. dhe vlera e mbetur prej 4,728 (katër mijë e shtatëqind e njëzet e tetë) euro mund të jetë nga kursimet *cash* nga ana e tij.

1.6.6 Kësti IV – në vlerën 8,500 (tetë mijë e pesëqind) euro, paguar më 4.7.2005 me depozitim në bankën “CBG (Emporiki)”. Nga hetimi i Komisionit, në lëvizjet e llogarisë bankare në “Raiffeisen Bank”, rezultoi se më 31.3.2005 bashkëshorti i subjektit ka depozituar shumën *cash* prej 679,613 (gjashtëqind e shtatëdhjetë e nëntë mijë e gjashtëqind e trembëdhjetë) lekë, e cila është mbyllur si depozitë kursimi. Në datën 4.7.2005, e cila është edhe data e pagesës së këstit të IV-të, bashkëshorti ka prishur depozitën e mësipërme dhe ka tërhequr shumën prej 700,000 (shtatëqind mijë) lekësh ose 5,697 (pesë mijë e gjashtëqind e nëntëdhjetë e shtatë) euro⁹.

1.7 Subjekti deklaroi se si burim për pagesën e këstit të III-të dhe të IV-t të apartamentit (kryer para martesë) ka shërbyer huaja e marrë nga babai i bashkëshortit, z. S. P., në shumën 30,000 (tridhjetë mijë) euro, marrë në janar të vitit 2005, e dokumentuar sipas Kontratës së Huas nr. *** rep., nr. *** kol., datë 14.2.2006.

1.8 Subjekti ka shpjeguar¹⁰ gjatw hetimit, ndër të tjera, se vëllai i bashkëshortit, shtetasi V. P., i cili jeton prej vitit 1999 në Itali dhe aktualisht është rezident në SHBA, ka kontribuar gjithashtu për një pjesë të huas së mësipërme në vlerën prej 20,000 (njëzet mijë) euro, duke bashkëngjitur deklaratën¹¹ e tij noteriale, bërë në vitin 2019.

1.9 Subjekti deklaroi se sipas informacionit që ka marrë nga bashkëshorti, shuma i është dhënë *cash* bashkëshortit nga babai i tij dhe një pjesë e saj është tërhequr nga vjehrra e saj nga ish-banka “FEFAD” (“ProCredit Bank” ka përthithur “FEFAD Bank”) ose nga “Banka e Kursimeve” (“Raiffeisen Bank” ka përthithur “Bankën e Kursimeve”), për të cilat subjekti nuk arriti të provonte deklarimin me dokumente ligjore.

1.10 Nga verifikimi i kryer vihet re se rreth datës së dhënies së huas (pra, në janar të vitit 2005), në të dyja bankat (“FEFAD Bank” dhe “Banka e Kursimeve”), në të cilat është deklaruar se mund të jetë kryer tërheqja e shumës përkatëse nga znj. P. P., këto banka kanë qenë të regjistruara nën emrin e blerësve të rinj të tyre, përkatësisht “ProCredit Bank” dhe “Raiffeisen Bank”¹². Nga hetimi i llogarive bankare të vjehrrës së subjektit mbi këto banka (me emrat e rinj), rezultoi një llogari e

⁸ Kursi i këmbimit zyrtar i Bankës së Shqipërisë, në datën 5.1.2005.

⁹ Vlera e konvertuar sipas kursit të këmbimit zyrtar të Bankës së Shqipërisë në datën 4.7.2005.

¹⁰ Shihni përgjigjet e pyetësorit, datë 16.12.2019 (pyetja 3.3, f. 9).

¹¹ Shihni deklaratën noteriale të z. V. P., me nr. *** kol., datë 16.7.2019 (përcjellë me pyetësorin, datë 16.12.2019).

¹² “Banka e Kursimeve” është shitur në datën 21.4.2004 sipas QKB-së (online) dhe “FEFAD Bank” është shitur më 1.12.2004 sipas QKB-së (online).

hapur në datën 30.3.2005, nga znj. P. P. në “Procredit Bank”, që vërehet se ka shërbyer vetëm si llogari page. Në vijim, në “Tirana Bank”, rezultoi një derdhje për depozitë me vlerë 200,000 (dyqind mijë) lekë në datën 8.9.2005, por të dyja këto llogari janë hapur pas datës së deklaruar të dhënies së huas te bashkëshorti i subjektit (në janar 2005). Megjithatë, gjatë hetimit rezultoi se në datën 18.10.2002, znj. P. P. ka hapur depozitë bankare (në lekë dhe në euro) në BKT, me vlerë 537,125 e pesë (pesëqind e tridhjetë e shtatë mijë e njëqind e njëzet e pesë) lekë dhe 1,030 (një mijë e tridhjetë) euro. Këto vlera nuk rezultojnë të jenë tërhequr prej saj rreth datës së deklaruar të huas.

1.11 Gjithashtu u verifikuan llogaritë bankare të vjehrrit të subjektit rreth kohës së deklaruar të dhënies së huas. Nga hetimi rezultoi se z. S. P. ka hapur depozitë me vlerë 34,530 (tridhjetë e katër mijë e pesëqind e tridhjetë) lekë në datën 18.10.2002, në BKT, por fondet e saj janë tërhequr pjesërisht vetëm në datën 16.8.2013, ndërsa në “Intesa Sanpaolo Bank”, vjehrrin e subjektit ka pasur llogarinë e pagës, duke filluar nga data 19.4.2005, edhe për vjehrrin e subjektit (z. S. P.) nuk rezultuan vlera të tërheqjeve të fondeve rreth datës së dhënies së huas (në janar të vitit 2005).

1.12 Për sa i përket formës së transferimit të vlerës monetare prej 20,000 (njëzet mijë) euro nga z. V. P. te z. S. P., subjekti deklaroi se nuk ka dijeni në lidhje me këtë fakt¹³, pasi ajo i takon periudhës para martesës së tyre dhe se kjo është diçka që lidhet me marrëdhëniet e tyre familjare.

1.13 Nga Komisioni u hetua mundësia për krijimin e shumës së dhënë hua në vitin 2005 nga z. S. P., të cilat u përdorën për huadhënie te bashkëshorti i subjektit (E. P.), duke konsideruar si vlerë huaje shumë prej 10,000 (dhjetë mijë) euro, sipas deklarimit më të fundit të subjektit¹⁴, si dhe mundësia e z.V. P..

1.14 Gjatë këtyre hetimeve, Komisioni mbajti në konsideratë faktin se kjo pasuri është shtëpia ku jeton subjekti i rivlerësimit me familjen e saj qysh prej krijimit dhe aktualisht edhe kontrata e shitjes, si dhe pagesat e disa kësteve janë kryer gjatë martesës së tyre (përfshi edhe vlerën e huas). Pavarësisht se subjekti i rivlerësimit, znj. Fjoralba Prifti, dhe z. E. P. kanë lidhur martesë në datën 8.2.2006, e cila korrespondon me lindjen e fëmijës së tyre të parë, gjatë hetimit administrativ rezultoi e provuar se znj. Fjoralba Prifti (Qinami) ka pasur njohje dhe lidhje me z. E. P. shumë kohë më parë se të lidhnin martesën, lidhje kjo e konstatuar edhe nga udhëtimet e përbashkëta (në sistemin *TIMS*), e pranuar edhe nga subjekti i rivlerësimit.

1.15 Nga vlerësimi i dokumentit Kontratë Huaje e përpiluar në datën 14.2.2006, vihet re se huaja është dhënë në janar të vitit 2005 (gati një vit më parë). Po ashtu, deklarimi i faktit të ri nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimeve të Komisionit, lidhur me burimin e të ardhurave të shumës së dhënë hua, duke përfshirë tanimë edhe z. V. P. me cilësinë e huadhënësit, rezultoi i padeklaruar më parë ndër vite dhe as në deklaratën *Vetting*, ku subjekti ka pasur detyrimin për të shpjeguar burimin e ligjshëm të të ardhurave të huadhënësit (neni 32/4), ku ka deklaruar si huadhënës vetëm z. S. P..

1.16 Në vlerësim të këtyre rrethanave krijohen dyshime se subjekti është përpjekur të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi, zotërim ose përdorim të saj, gjatë plotësimit të deklaratës *Vetting* (pika 5, e nenit D, të Aneksit të Kushtetutës dhe pika 4, e nenit 32, të ligjit nr. 84/2016).

1.17 Pas vlerësimit të dokumentacionit të administruar në Komision lidhur me burimin e ligjshëm të të ardhurave të z. E. P., rezultoi se subjekti arrin të justifikojë si të ardhura të ligjshme (sipas përcaktimit të pikës 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës) vetëm vlerën totale prej 23,819 (njëzet e tre mijë e tetëqind e nëntëmbëdhjetë) euro nga totali i pagesës së apartamentit prej 78,500 (shtatëdhjetë e tetë mijë e pesëqind) euro.

¹³ Përgjigjet e pyetësorit, datë 23.4.2020 (pyetja 4).

¹⁴ Përgjigjet e pyetësorit të datës 16.12.2019.

1.18 Duke marrë në konsideratë korrespondencën e Komisionit me organet tatimore¹⁵ dhe ISSH-në¹⁶, nuk kanë rezultuar të dhëna lidhur me të ardhurat e prindërve të z.E. P., (S. dhe P. P.). Po ashtu i paprovuar mbetet edhe burimi i të ardhurave të z.V. P., e për pasojë edhe burimi i ligjshëm i të ardhurave nga huaja në shumën 30.000 euro.

1.19 Në DPV-në e vitit 2007 subjekti deklaroi shlyerje të detyrimit prej 12,000 (dymbëdhjetë mijë) euro për këto pasuri, sipas Kontratës së Sipërmarrjes në datën 15.3.2014 dhe në DPV-në e vitit 2013 subjekti deklaroi shlyerje totale të detyrimit financiar ndaj shoqërisë “****” sh.a., në vlerën prej 5,190 (pesë mijë e njëqind e nëntëdhjetë) euro.

1.20 Kësti V – në vlerën 12,000 (dymbëdhjetë mijë) euro është paguar *cash* në datën 30.5.2007 me mandatpagesë, me shoqërinë “****” sh.a.”.

1.21 Kësti VI – në vlerën 5,190 (pesë mijë e njëqind e nëntëdhjetë) euro është paguar në datën 5.7.2013, me depozitim në llogarinë e shoqërisë “****” sh. a.” në bankën “CBG (Emporiki)”.

1.22 Nga hetimi i Komisionit, në lëvizjet e llogarive bankare të bashkëshortit, gjatë periudhave kur janë realizuar këto pagesa, nuk rezultoi ndonjë vlerë e tërhequr rreth datës së pagesës së kësteve (V dhe VI). Duket se bashkëshorti i subjektit i ka kryer këto pagesa me të ardhura të mbajtura *cash*.

1.23 Pas hetimit të dokumentacionit të përcjellë në Komision lidhur me burimin e ligjshëm të të ardhurave, rezultoi se subjekti arrin të justifikojë si të ardhura me burime të ligjshme vlerën totale prej 5,934 (pesë mijë e nëntëqind e tridhjetë e katër) euro, nga pagesa prej 17,190 (shtatëmbëdhjetë mijë e njëqind e nëntëdhjetë) euro e kryer për blerjen e pasurisë.

1.24 Komisioni ka hetuar lidhur detyrimin për shlyerjen e huas prej 30,000 (tridhjetë mijë) euro, marrë z. S. P., (babait të bashkëshortit) në vitin 2005, sipas deklaramit të subjektit të rivlerësimit.

1.25 Referuar Kontratës së Huas nr. ***, datë 14.2.2006, të nënshkruar nga shtetasi S. P., kthimi i kësaj huaje duhet të likuidohet plotësisht brenda një afati 5-vjeçar (pra, në janar të vitit 2010).

1.26 Referuar deklaratës *Vetting* dhe DPV-së, huaja ishte ende e pakthyer dhe me detyrim të mbetur në vlerën totale prej 30,000 (tridhjetë mijë) euro.

1.27 Lidhur me shkaqet e moslikuidimit të kësaj huaje, nisur edhe nga fakti se subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti i saj kanë pasur mundësi financiare, gjendje likuiditetesh, për shlyerjen e saj sipas përcaktimeve në kontratën e huas, subjekti sqaron¹⁷ se kjo vlerë është kthyer në datën 15.7.2019, nga llogaria e “Raiffeisen Bank” e bashkëshortit të saj (E. P.) drejt llogarisë bankare në BKT të vjehrrit të saj, z. S. P., në kundërvleftën në lekë (3,660,000 lekë) të detyrimit të kontratës së huas.

1.30.1 Subjekti i rivlerësimit shpjegon ndër të tjera se ky detyrim për shkak të marrëdhënies së huadhënësit me huamarrësin (marrëdhënie e ngushtë e gjinisë mes prindit dhe fëmijës) nuk është kthyer më herët për shkak se nuk është kërkuar më parë dhe sepse në apartamentin për të cilin është dhënë kjo hua, prindërit e bashkëshortit kanë jetuar për periudha afatgjata kohore (2007 – 2015), qoftë edhe për shkak të moshës së tyre.

1.30.2 Subjekti vazhdon të sqarojë se huaja është kthyer në datën e mësipërme për shkak të transferimit të kumatit të saj rezident në Itali, drejt SHBA-së në korrik të vitit 2019 dhe, me këtë rast, për shkak të nevojave të pritshme për likuiditete nga ana e tij, me kërkesën e vjehrrit të saj, është kthyer edhe vlera e huas¹⁸.

¹⁵ Shkresë nr. *** prot., datë 21.2.2019, nga DRT-ja.

¹⁶ Shkresë nr. *** prot., datë 13.2.2019, nga ISSH dhe nr. ***, datë 5.3.2019, nga ISSH Arkiva.

¹⁷ Përgjigje e pyetësorit nr. 3, datë 31.1.2020 (pyetja 2) (bashkëngjitur vërtetimi i “Raiffeisen Bank” për transaksionin e kryer).

¹⁸ Përgjigje e pyetësorit nr. 3, datë 31.1.2020 (pyetja 2).

1.28 Referuar shkresës së BKT-së¹⁹ ardhur në Komision, konstatohet kthimi i vlerës së huas te z. S. P. dhe se vlera ishte ende gjendje në llogarinë e z. S. P..

1.29 Nga hetimi administrativ, në lidhje me kthimin e huas te z. S. P., vihet re se: (a) subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti kanë pasur mundësi financiare të kthejnë shumën e marrë hua brenda afateve të përcaktuara në kontratë, por kthimi i saj është bërë vetëm në datën 15.7.2019; (b) subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provonte bindshëm shkaqet pse kjo hua është kthyer në datën 15.7.2019, duke vlerësuar se ata kanë disponuar vazhdimisht likuiditete dhe se kjo marrëdhënie nuk ishte dokumentuar asnjëherë; dhe (c) kthimi i huas është bërë në kohën kur Komisioni ka pyetur lidhur me këtë marrëdhënie huaje.

1.30 Në përfundim të hetimit administrativ, Komisioni konstaton se:

- a) Subjekti nuk ka deklaruar në DPV-në e vitit 2006 pasurinë e bashkëshortit dhe burimin e vlerës prej 78,500 (shtatëdhjetë e tetë mijë e pesëqind) euro, e cila ka shërbyer për krijimin e saj.
- b) Z. E. P. nuk justifikon me burime të ligjshme dhe të provuara të ardhurat e tij për pagesën e kësteve të apartamentit, në total vlerën 54,681 (pesëdhjetë e katër mijë e gjashtëqind e tetëdhjetë e një mijë) euro. Nga hetimi i llogarive bankare të bashkëshortit të subjektit rezultoi se ai vazhdimisht derdh në bankë shuma të ardhurash *cash*, për të cilat mbetet i paprovuar burimi i ligjshëm i tyre.
- c) Subjekti rivlerësimit nuk ka deklaruar në deklaratën *Vetting* z. V. P. me cilësinë e huadhënësit, si dhe nuk arriti të provojë burimin e të ardhurave të z. S. P. dhe z. V. P. për dhënie e huas dhe t'i mbështesë ato me dokumentacion ligjor provues sipas kërkesave të nenit 32/4 të ligjit nr. 84/2016.

1.30.1 Nga hetimi i Komisionit, duke tërhequr deklaratimet e subjektit në ILDKPKI ndër vite si dhe dokumentet shoqëruese, nuk arrihej një rezultat i ndryshëm lidhur me ligjshmërinë e burimit të të ardhurave të z. E. P..

- d) Duket se bashkëshorti i subjektit nuk ka përdorur për kryerjen e pagesave të kësteve të apartamentit huan e marrë në janar të vitit 2005, por të ardhura të tjera të tij, të cilat kanë qenë të mbajtura (pjesërisht) në bankë.

1.31 Në përfundim, në bazë të nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni i kaloi subjektit të rivlerësimit barrën e provës për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit pas kalimit të barrës së provës

1.32 Në vijim të rezultateve të hetimit, subjekti ka shpjeguar në lidhje me burimin e financimit të pasurive të krijuara para martesës, duke shpjeguar se këto pasuri janë krijuar nga të ardhurat e bashkëshortit të saj para martesë, në periudhën rreth viteve 1997 – 2005, si dhe nga një hua e dhënë nga familjarët e tij, e formalizuar me Kontratën e Huasë nr. *** rep., nr. *** kol., datë 14.2.2006 të lidhur mes vjehrrit të saj S. P. dhe bashkëshortit të saj E. P..

1.33 Në lidhje me burimet e të ardhurave nga bursat e z. E. P., subjekti shpjegon: *“Komisioni nuk konsideron si të ardhura vlerën e bursave studimore të akorduara bashkëshortit tim sipas dokumenteve justifikuese, të cilat i janë bashkëngjitur deklaratës Vetting, të përcjella të përkthyer gjatë hetimit administrativ bashkë me përgjigjet e pyetësorit nr. 3, të datës 31.1.2020.*

Të ardhurat nga bursa janë të ardhura të përjashtuara nga detyrimet tatimore si nga legjislacioni shqiptar edhe ai i huaj. Neni 8/1.b i ligjit nr. 8438/1998 i ndryshuar përcakton se: ‘Përjashtohen nga tatimi mbi të ardhurat personale: 2. Bursat e nxënësve dhe të studentëve. Njëkohësisht një parashikim të tillë ka edhe ligji gjerman (neni 3.44 i ligjit ‘Për të ardhurat’, datë 16.10.1934, i ndryshuar i Republikës Federale Gjermane): ‘Bursat përjashtohen nga tatimi mbi të ardhurat, në

¹⁹Shihni shkresën nr. *** prot., datë 3.7.2020, e BKT-së.

qoftë se ato vijnë nga mjete financiare publike'. DAAD dhe institucionet e mësipërme financojnë me para publike. Ky fakt përcaktohet edhe në faqen zyrtare të DAAD-së”.

Subjekti sqaron ndër të tjera se: “... nëse Komisioni mbështet qëndrimin e ILDKPKI-së, në faqen 41 të Raportit të tij, se këto të ardhura kanë si qëllim dhe janë llogaritur për të mbuluar shpenzimet studimore dhe nuk mund të llogariten si burim për krijimin e aseteve, ky qëndrim është i gabuar.

Në kuptimin ndërkombëtar të termit ‘bursë’, ajo përfaqëson një mbështetje financiare për një person që kryen studime apo kërkime shkencore. Bursa përbën një burim financiar të përjashtuar nga tatimi sipas nenit 8/1 të ligjit nr. 8438/1998, ‘Për tatimin mbi të ardhurat’ dhe njëkohësisht një të ardhur të ligjshme.

Përgjithësisht ajo akordohet për personat e varfër, pa të ardhura apo për persona që angazhohen në kryerjen e studimeve, apo kërkimeve shkencore për shkak të meritës, nëpërmjet konkursit për përfitim të saj.

Në rastin konkret, bashkëshorti im i ka përfutur bursat për shkak të meritës, pas një konkurrimi pranë institucionit, që akordon bursën dhe kjo e fundit është akorduar me qëllim mbështetjen financiare të kostove të jetesës së një akademiku gjerman.

Unë mendoj se ashtu sikurse Komisioni, në analizën financiare llogarit për subjektet e rivlerësimit si shpenzime për kosto jetese kostot minimale të jetesës sipas INSTAT-it në periudhat përkatëse, në të njëjtën mënyrë Komisioni duhet të llogarisë në analizën financiare edhe kostot e jetesës në Gjermani apo vendet e BE-së për shkak të qëndrimit në këto vende për arsye studimore.

Në këto kushte, Komisioni duhet të konsiderojë të ardhura të ligjshme të gjitha të ardhurat e përfutuara nga bursat e evidentuara më sipër dhe, pasi të llogarisë kostot e jetesës për bashkëshortin tim në periudhën e qëndrimit në Gjermani për arsye studimore duke iu referuar të dhënave statistikore të institucioneve kompetente gjermane mbi kostot e jetesës së studentëve në Gjermani në atë periudhë, të vlerësojë mundësitë objektive të kursimit nga këto të ardhura.

Në total nga llogaritjet mundësia objektive për kursim nga të ardhurat nga bursat ka qenë 14.770 euro, duke marrë për bazë të dhënat statistikore të institucioneve kompetente gjermane mbi kostot e jetesës së studentëve në Gjermani në atë periudhë.

Si përfundim, në lidhje me këtë çështje, ashtu sikurse Komisioni llogarit për subjektet e rivlerësimit kostot minimale jetike në Shqipëri nga të dhënat zyrtare të INSTAT-it, ai në zbatim të neneve 11/ç e 17, të Kodit të Procedurës Administrative duhet të udhëhiqet nga parimi i ushtrimit të ligjshëm të diskrecionit dhe parimi i barazisë dhe të zbatojë të njëjtën metodologji edhe për kostot e qëndrimit të bashkëshortit tim në Gjermani, pasi situata të njëjta objektive duhet të trajtohen në të njëjtën mënyrë. Nëse do të konsiderohej arsyetimi dhe llogaritja e mësipërme, vlera e justifikuar e të ardhurave të subjektit para martesë do të ishte 38.589 euro.”

1.34 Lidhur me burimin e të ardhurave të z. S. P.: (a) subjekti ka përcjellë shkresën nr. ***prot., datë 19.5.2020, të DRSSH-së Korçë, ku deklarohen të ardhurat nga punësimi i z. S. P. dhe znj. P. P.; (b) subjekti ka përcjellë ekstraktin e llogarisë së sigurimit nga Instituti Kombëtar i Sigurimeve Shoqërore në Itali, i cili pasqyron të ardhurat e z. V. P. në shtetin italian për periudhën 10.6.2000 - 31.12.2018. Nga këto të dhëna në vitin 2004, të ardhurat e tij rezultojnë 14.629 (katërmëdhjetë mijë e gjashtëqind e njëzet e nëntë) euro.

Subjekti shpjegon: “Në lidhje me konstatimin e Komisionit, bashkëshorti im shpjegon se këto para i janë dhënë ‘deri në janar 2005’ që korrespondon me kryerjen e pagesave të kësteve I, II dhe III të Kontratës së Porosisë së datës 15.3.2004.

Ai dhe babai i tij nuk kanë mbajtur shënim datën konkrete të dhënies së parave, ndërkohë që lidhja e kontratës ka pasur si qëllim dokumentimin e detyrimit dhe jo kohën e lindjes së tij.

Mosshënimi në aktin noterial i fjalës 'deri' para shprehjes 'janar 2005' nuk është konsideruar si mangësi thelbësore e kontratës prej tyre, për vetë qëllimin për të cilin është lidhur ajo.

*Nga deklaratata personale e vjehrrit tim z. S. P. e datës 20.8.2020²⁰ sqarohet se shuma e dhënë hua me kontratën nr. ***, datë 14.2.2006 është dhënë deri në vitin 2005 me qëllim blerjen e apartamentit të porositur nga bashkëshorti im në vitin 2004.”*

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në raport me faktet dhe me ligjin e zbatueshëm

1.35 Lidhur me:

- **të ardhurat nga puna në Gjermani** në muajt janar - korrik 2000 si punonjës biblioteke në institutin “***”, Golm kanë qenë 4,000 (katër mijë) euro;
- **të ardhurat prej 6,000 (gjashtë mijë) euro** me përafërsi nga angazhimi si asistent i projektit të “***” në periudhën shtator 2000 - shtator 2001 dhe një pagesë të përafërt prej 1,000 (një mijë) marka/500 (pesëqind) euro/muaj;
- **të ardhurat prej 10,000 (dhjetë mijë) euro** me përafërsi nga angazhimi si përkthyes nga “***” në periudhën 2001 – 2005;
- **të ardhurat prej “***” rreth 1,300,000** (një milion e treqind mijë) lekë nga mësimdhënia e gjuhës gjermane në periudhën 1998 – 2005;
- **të ardhura në vlerën 200,000 (dyqind mijë) lekë rreth viteve 2003 - 2005** nga korrektimi i fjalorit gjermanisht-shqip i autorit A. Dh.;

Subjekti nuk ka përcjellë informacion apo dokumentacion shtesë për të provuar deklaratimet e saj, duke rikërkuar nga Komisioni të zbatohet nenin 32/2 i ligjit nr. 84/2016 dhe njohjen e pamundësisë për të disponuar dokumentet provuese të ligjshmërisë së të ardhurave.

1.36 Për të ardhura nga përkthimet në periudhën 1997 – 2005 për institucione dhe individ të ndryshëm. Subjekti nuk ka përcjellë informacion apo dokumentacion shtesë për të provuar deklaratimet e saj dhe deklaroi se nuk ka fatura të mbajtura për këto shërbime. Për këto të ardhura subjekti shprehet se ka kaluar afati 6-vjeçar i ruajtjes, i përcaktuar në nenin 7 të ligjit nr. 7758, datë 12.10.1993.

1.37 Në analizë të fakteve dhe provave të mbledhura gjatë hetimit, si dhe pretendimeve të subjektit të rivlerësimit se kjo ishte një pasuri e bashkëshortit të saj e krijuar para martesë, nuk e përjashtojnë atë nga detyrimi për të provuar ligjshmërinë e krijimit të asaj pasurie. Trupi gjykues çmon se referuar pikës 1, të nenit Ç, të Aneksit të Kushtetutës, rivlerësimi i subjekteve për kriterin e kontrollit të pasurive kryhet nga organet e rivlerësimit, në përputhje me përcaktimet e nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe dispozitave përkatëse të ligjit nr. 84/2016. Në kuptim të dispozitës së sipërcituar kushtetuese dhe kreut IV të ligjit nr. 84/2016, çdo pasuri, sipas kuptimit të dhënë në pikën 11, të nenit 3, të ligjit të rivlerësimit, që është objekt deklarimi në deklaratën e pasurisë *Vetting*, i nënshtrohet kontrollit të plotë mbi vërtetësinë, saktësinë e deklarimit dhe ligjshmërinë e burimeve të krijimit, pa asnjë dallim dhe kufizim, i artikuluar ky sipas kriterit të kohës së krijimit apo çdolloj kriteri tjetër përcaktues.

1.38 Nëpërmjet procedurës së kontrollit të pasurive synohet identifikimi i atyre subjekteve të rivlerësimit, të cilët janë bërë përfitues apo përdorues të pasurive në mënyrë të paligjshme apo me të ardhura, ligjshmëria e të cilave, referuar standardit të përcaktuar në pikën 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës, vihet në dyshim pavarësisht nëse ky fakt nuk lidhet në mënyrë të drejtpërdrejtë me ushtrimin e detyrës së subjektit apo rezulton të ketë ndodhur jashtë periudhës kohore të ushtrimit të saj. Konfirmimi i një marrëdhënieje të tillë të magjistratit në raport me ligjin,

²⁰ Subjekti ka përcjellë në Komision një deklaratë personale të z. S. P. të datës 20.8.2020, ku deklaroi se huaja i është dhënë bashkëshortit të subjektit deri në janar të vitit 2005.

qoftë në formën e veprimeve të tij në kundërshtim me ligjin apo edhe në formën e pranimit të veprimeve të personave të lidhur me të, cenon vlerat themelore të tij, si rrjedhojë, edhe besimin që ai duhet të përcjellë te publiku në përmbushjen e misionit/rolit në dhënien e drejtësisë. Për rrjedhojë, vlerësimi i kësaj pasurie, si dhe burimi i ligjshëm i krijimit të saj janë objekt vlerësimi gjatë procesit të rivlerësimit të subjektit.

1.39 Në vlerësim të provave dhe shpjegimeve të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, trupi gjykues çmon se shprehja e vullnetit para noterit publik nga z. S. P., në datën 20.8.2020 ka karakter deklarativ, në drejtim të njohjes apo pranimit prej tij se ka dhënë shumën prej 30,000 (tridhjetë mijë) euro, si dhe qëllimin e dhënies së kësaj shume. Qëllimi tjetër i redaktimit të kësaj deklaratë është që subjekti i rivlerësimit ta paraqesë atë në Komision. Edhe fakti që kjo deklaratë është redaktuar në datën 20.8.2020, e konfirmon këtë qëllim.

1.47.1 Po ashtu edhe Kontrata e Huas e lidhur në datën 14.2.2006 (mbi një vit pas dhënies së huas) e dorëzuar në ILDKPKI në vitin 2006, ka pasur të njëjtin qëllim.

1.47.2 Sa më sipër, trupi gjykues arrin në konkluzionin se veprimet juridike të përshkruara, të cilat nuk kanë sjellë pasoja juridike, duket se kanë pasur për qëllim justifikimin e burimit të krijimit të pasurive nga bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit për efekt të procesit të verifikimit të pasurisë.

1.40 Në zbatim të neneve 30 dhe 31 dhe shtojcës 2 të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit kishte detyrimin të deklaronte të gjitha pasuritë ndër vite deri në ditën e dorëzimit të deklaratës së pasurisë, ligjishmërinë e burimit të krijimit të tyre, përmbushjes së detyrimeve financiare, për vete dhe për persona e lidhur me të. Pika 11, e nenit 3, të ligjit nr. 84/2016 parashikon: *“Pasuri” janë të gjitha pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme në Republikën e Shqipërisë ose jashtë saj, sipas parashikimit të nenit 4 të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”*, i ndryshuar, që janë në pronësi, posedim ose në përdorim të subjektit të rivlerësimit. Ndërkohë që sipas gërmës “a”, të nenit 4, të ligjit nr. 9049/2003, parashikohet se: *“Subjektet e përcaktuara në nenin 3 të këtij ligji detyrohen të deklarojnë në ILDKPKI brenda datës 31 mars të çdo viti, gjendjen deri më 31 dhjetor të vitit paraardhës të interesave private, brenda dhe jashtë territorit të Shqipërisë, burimet e krijimit të tyre, si dhe të detyrimeve financiare si më poshtë: a) pasuritë e paluajtshme dhe të drejtat reale mbi to, sipas Kodit Civil [...]”*.

1.41 Në analizë të fakteve si më sipër, trupi gjykues çmon se vonesa në kthimin e huas është varur kryesisht nga vullneti i subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortit të saj për të kryer veprimin juridik të kthimit të huas, i cili ka shërbyer si burim ligjor krijimi për pasurinë apartament banimi me sip. 121.29 m² dhe garazh me sip. 17 m², në Tiranë. Kjo sidomos kur rezulton se kontrata e huas e sipërcituar është lidhur pas marrjes së shumës prej z. E. P. dhe kthimi i saj është kryer në vitin 2019, pas kërkesës së bërë nga Komisioni për efekt të procesit të rivlerësimit dhe gjatë zhvillimit të hetimit administrativ nga Komisioni.

1.42 Trupi gjykues arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaratime të pasaktë në deklaratën *Vetting* për sa i përket këtij burimi të ardhurash për të krijuar këtë pasuri, sipas parashikimit të gërmës “ç”, të pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/201612, duke mos e njohur këtë shumë si një burim të ardhurash të ligjshme për t’u konsideruar si e tillë në analizën financiare për këtë pasuri, pasi e paprovuar dhe e pabesueshme konsiderohet të jetë edhe marrëdhënia e huas në këtë shumë, sipas deklaratimeve të mëpasshme të subjektit të rivlerësimit.

1.43 Për më tepër, kontrata e huas e deklaruar se është lidhur mes z. E. P. dhe babait të tij, e cila përcakton kthimin e shumës në pesë vjet, fakti i deklaruar nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit se të ardhurat kanë qenë edhe të z.V. P. dhe se ai ka punuar në emigracion dhe pa dokumente e në kushte modeste, si dhe moskthimi i kësaj huaje deri në vitin 2019 (rreth 14 vjet më vonë) duket aspak realiste për natyrën e një marrëdhënie huaje, analizuar edhe me pamundësinë financiare të

familjarëve të tij për ta pasur në dispozicion këtë shumë, për sa rezulton nga një analizë e thjeshtë logjike e matematike e të ardhurave të tyre të deklaruara prej subjektit, të çojnë në konkluzionin se subjekti nuk ka arritur të provojë as marrëdhënien e huas së deklaruar prej tij dhe as burimet e ligjshme të personit tjetër të lidhur (babai i subjektit) për të krijuar këtë pasuri apo z.V. P..

1.51.1 Mbetet gjithashtu i paprovuar pretendimi i subjektit se shuma e dhënë hua vjen nga të ardhurat e vëllait të bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit, z.V. P., të krijuara nga puna e tij në emigracion, duke paraqitur si provë vetëm faktin se ai ka qenë emigrant. Të dhënat e prezantuara, nuk provojnë të ardhurat e pretenduara dhe as dhënien e huas, në funksion të detyrimit që ka subjekti i rivlerësimit në këtë proces, për të provuar me dokumentacion burimet e krijimit të pasurisë që ai ka në pronësi, posedim apo përdorim të tij.

1.51.2 Mbështetur edhe në praktikën e Kolegjit, me qëllim që remitancat të vlerësohen gjatë procesit të rivlerësimit të subjektit si të ardhura të ligjshme, nevojitet që ato të provohen se janë dërgesa vlerash monetare të emigrantëve shqiptarë në vendin e origjinës, të cilat janë realizuar nga burime të ligjshme dhe për të cilat janë përmbushur detyrimet përkatëse tatimore në vendin e krijimit.

1.51.3 Referuar dokumentacionit të administruar gjatë hetimit administrativ në Komision, subjekti i rivlerësimit arriti të provojë faktin që vëllai i bashkëshortit të saj ka qenë emigrant ekonomik në Itali. Përtej këtij fakti, subjekti nuk arriti të përmbush kërkesat e nenit 21 të udhëzimit nr. 4095 prot., datë 10.10.2016, të Inspektorit të Përgjithshëm të ILDKPKI-së, për sa kohë aktet shkresore të administruara në cilësinë e provës nuk arritën të provojnë faktin e punësimit të personit tjetër të lidhur dhe nivelin e të ardhurave të ligjshme të krijuara gjatë kësaj periudhe. Në këtë kuptim, në zbatim të pikës 4, të nenit 32, të ligjit nr. 84/2016, kjo shumë e pretenduar nga subjekti se ka shërbyer si burim për krijimin e pasurisë apartament dhe garazh i ndodhur në Tiranë, nuk do të konsiderohet si e tillë në analizën financiare.

1.44 Të gjitha sjelljet e subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues i ka parë të lidhura me veprimet fiktive të kryera prej saj, të përshkruara në paragrafët më sipër, të cilat nuk kanë sjellë asnjë pasojë juridike mbi pasurinë, por kanë pasur për qëllim justifikimin e burimit të krijimit të saj.

1.45 Trupi gjykues çmon të theksojë se në procesin e rivlerësimit konstatimi i fiktivitetit të veprimeve juridike nuk ka për qëllim dhe nuk mund të sjellë zgjidhjen e pasojave të palët pjesëmarrëse në të, por është një analizë e ligjshmërisë ose jo të veprimeve juridike të kryera, të cilat ndikojnë në legjitimitetin e pasurisë së krijuar si rezultat i këtyre veprimeve, për pasojë objekt verifikimi në kuptim të pikës 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës.

1.46 Në lidhje me ligjshmërinë e burimit të të ardhurave të deklaruara nga bashkëshorti si burim për krijimin e kësaj pasurie, Komisioni, në vlerësim të shpjegimeve të subjektit i pranon ato për sa i përket të ardhurave nga bursat e studimit duke vlerësuar përpjekjen e subjektit për të paraqitur dokumente dhe shpjegime ligjore, si dhe pranon arsyetimet e subjektit lidhur me zbritjen e shpenzimeve sipas një minimumi jetik duke e konsideruar shumën prej 14,770 euro, ose 1,827,093 lekë, si të ardhur të ligjshme.

1.47 Lidhur me kërkesën e subjektit për të konsideruar si të ardhura të ligjshme të ardhurat e tjera të përfituara prej tij, për të cilat subjekti nuk ka mundur të provojë pagimin e detyrimeve tatimore sipas parashikimeve të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, Komisioni nuk ka pranuar shpjegimet e subjektit, pasi nuk i gjen ato në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 84/2016 dhe me nenin D të Aneksit të Kushtetutës.

1.55.1 Mbështetur në kërkesën e subjektit gjatë hetimit, Komisioni i ka kërkuar ILDKPKI-së dokumentacionin mbështetës të dërguar nga subjekti i rivlerësimit së bashku me deklaratimet e saj ndër vite, nga i cili nuk ka rezultuar gjithashtu ndonjë dokument që të provonte se subjekti i rivlerësimit është kujdesur për të provuar ndër vite, pagimin e detyrimeve tatimore të të ardhurave

të përfituara nga bashkëshorti i saj ndër vite dhe, në disa raste, as dokumentacion ligjor provues se marrëdhënia e punës ka ekzistuar.

1.55.2 Shkresa e marrë prej subjektit të rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, por edhe nga Komisioni, nga organet tatimore, nuk provonte rregullin e përcaktuar në pikën 2, të nenit 32, të ligjit nr. 84/2016, se ky informacion nuk gjendej në regjistrat elektronikë (në sistemin informatik) dhe se subjekti nuk arriti t'i vërtetojë Komisionit se dokumentacioni provues mbi ligjshmërinë e të ardhurave objekt vlerësimi është zhdukur, ka humbur, nuk mund të bëhet përsëri ose nuk mund të merret në rrugë tjetër, e se subjekti nuk ndodhet në kushtet e pamundësisë objektive sipas pikës 2, të nenit 32, të ligjit nr. 84/2016.

1.48 Në përfundim të arsytimit, trupi gjykues arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit gjendet në kushtet e deklarimit të pamjaftueshëm në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit për pasurinë apartament banimi me sip. 121.29 m² dhe garazh me sip. 17 m², në Tiranë, duke mos justifikuar me burime të ligjshme financiare në masën prej në masën prej (-) 7,200,201 lekësh (nga të cilat para martese në vlerën 5,801,415 lekë dhe pas martese në vlerën 1,398,786 lekë) krijimin e kësaj pasurie, si edhe rezulton se ka bërë deklaram të rremë në deklaratën *Vetting*, për sa i përket natyrës së marrëdhënies juridike nëpërmjet së cilës bashkëshorti i saj ka përfituar si burim për krijimin e pasurisë, shumë prej 30,000 (tridhjetë mijë) euro, të cituar si një prej burimeve financiare për krijimin e kësaj pasurie, duke u gjendur para kushteve të parashikuara nga gerमत "b" dhe "ç", të pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016.

2. Tokë "arë", me sipërfaqe 540 m², nr. pasurie ***, në ***, Tiranë, e përfituar me trashëgim nga trashëgimlënësi, i ndjeri I. K. (daja i subjektit), regjistruar në ZVRPP-në Tiranë, datë 26.2.2015. Pjesa takuese: 3/72 pjesë në bashkëpronësi.

2.1 ZVRPP-ja²¹ Tiranë konfirmon se për shtetasen Fjoralba Fadil Prifti figuron e regjistruar pasuria me nr. ***, e llojit arë, me sip. 135 m², në bashkëpronësi me shtetasit S. M. K., F. F. Q. dhe E. F. Q. (bashkëngjitur përcillet vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, datë 30.10.2017, me objekt "pjesëtimi i pasurisë me sip. 540 m² e llojit arë, në ***, Tiranë").

2.2 Nga hetimi ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar në DPV-në e vitit 2014 çeljen e trashëgimisë dhe as në DPV-në e vitit 2015 përfitimin e kësaj pasurie pas regjistrimit në ZVRPP.

2.3 Subjekti sqaron në lidhje me këtë konstatim të Komisionit se deklarimin e kësaj pasurie e ka deklaruar në DPV-në e vitit 2016, dorëzuar më 21.3.2017, edhe në deklaratën *Vetting* dorëzuar në janar të vitit 2017. Daja i saj, i ndjeri I. K., ka ndërruar jetë më 19.5.2012. Dëshmia e trashëgimisë për të është lëshuar në datën 17.3.2014, nga notere O. G. mbi kërkesen e znj. R. K. (bashkëshorte e të ndjerit).

2.4 Regjistrimi i dëshmisë në ZVRPP-në Tiranë është bërë me kërkesë të saj dhe, për këtë arsye, subjekti nuk ka pasur dijeni se ishte lëshuar dëshmia e trashëgimisë. Ajo nuk ka pasur as dijeni për regjistrimin e saj në ZVRPP. Subjekti sqaron, ndër të tjera, se ka marrë dijeni se kjo pasuri ishte regjistruar dhe, për pasojë, ishte lëshuar edhe dëshmia e trashëgimisë, pasi ishte njoftuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë për padinë e paraqitur nga znj. R. K. në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me objekt pjesëtimin e kësaj pasurie. Në këtë gjykim, subjekti është thirrur si palë e paditur, por nuk ka marrë pjesë asnjëherë në gjykim.

2.5 Për sa i përket vendimit nr. ***, datë 30.10.2017, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, padia është regjistruar në gjykatë në datën 4.11.2016 dhe, për pasojë, për shkak të rregullave procedurale civile, subjekti në këtë periudhë duhet të njoftohej për padinë brenda afatit 10-ditor të përcaktuar në nenet 155 dhe 158 të Kodit të Procedurës Civile. Subjekti nuk ka ruajtur aktin e njoftimit të

²¹Shihni shkresën me nr. ***prot., datë 8.3.2019, nga ZVRPP-ja Tiranë (bashkëngjitur kartela e pasurisë dhe vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë datë 30.10.2017, me objekt pjesëtimi i pasurisë tokë "arë" me sip. 540 m²).

padisë, por ky është një fakt lehtësisht i verifikueshëm nga Komisioni nëse kjo çështje paraqet rëndësi. Pikërisht në këtë periudhë, subjekti ka marrë dijeni për lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë dhe për regjistrimin e saj në ZVRPP-në Tiranë dhe me marrjen dijeni, ajo e ka deklaruar në deklaratën *Vetting* dhe në DPV-në e vitit 2016.

2.6 Subjekti sqaron se nuk ka pasur interes për këtë pronë edhe për faktin se pjesa takuese e saj ishte e papërfillshme, vetëm 22 m².

2.7 Në përfundim, Komisioni ka pranuar shpjegimet e subjektit lidhur me këtë pasuri.

3. Subjekti, në deklaratën *Vetting*, deklaroi pasuri në formë monetare ose në tituj qeveritarë, në total në vlerën 21,711,962 (njëzet e një milion e shtatëqind e njëmbëdhjetë mijë e nëntëqind e gjashtëdhjetë e dy) lekë, të cilat janë prezantuar si më poshtë:

3.1 Obligacione në vlerën 400,000 (katërqind mijë) lekë, të emetuara në datën 23.4.2015, në BKT, të krijuara nga kursime nga paga dhe interesa nga llogari depozite²² me titullar znj. Fjoralba Prifti.

3.2 Depozitë me vlerë fillestare 2,500,000 (dy milionë e pesëqind mijë) lekë në BKT, datë 26.4.2013, me nr. ref ***, krijuar nga kursimet nga paga²³ me titullar znj. Fjoralba Prifti.

3.3 Pas hetimit të llogarive bankare rezultoi se subjekti i ka krijuar këto pasuri monetare me kursimet e mbajtura në bankë nga të ardhurat nga paga në vite.

3.4 Obligacione me nr. ***, në vlerën 655,902 (gjashtëqind e pesëdhjetë e pesë mijë e nëntëqind e dy) lekë dhe me nr. ***, në vlerën 1,100,000 (një milion e njëqind mijë) lekë, në “Raiffeisen Bank”, me titullar znj. Fjoralba Prifti, të krijuara nga kursimet dhe interesa depozite në këtë bankë²⁴.

3.5 Nga hetimi i llogarive rezultoi se këto pasuri janë krijuar nga paga e subjektit (e marrë deri në vitin 2007), e cila është mbajtur në formën e depozitave bankare për periudhën 2005 – 2015, kur janë përdorur për blerjen e obligacioneve.

3.6 Depozita (në tri llogari të ndryshme) me vlerë totale 5,348,500 (pesë milionë e treqind e dyzet e tetë mijë e pesëqind) lekë në BKT, të krijuara nga të ardhurat dhe kursimet nga paga, interesa bankare dhe përkthime, me titullar z. E. P..

3.7 Pas hetimit të llogarive bankare rezultoi se bashkëshorti i ka krijuar këto pasuri monetare me kursimet e mbajtura në BKT dhe prej vlerave të kursyera në banka të tjera, por të transferuara në këtë bankë në këtë periudhë.

3.8 Obligacione me nr. ***, në vlerën 6,457,560 (gjashtë milionë e katërqind e pesëdhjetë e shtatë mijë e pesëqind e gjashtëdhjetë) lekë, të emetuara në datën 23.4.2015 dhe me nr. 202693, datë emetimi 16.6.2015, në “Raiffeisen Bank”, të krijuara nga kursimet nga të ardhurat, me titullar z. E. P..

3.9 Pas hetimit të llogarive bankare rezultoi se bashkëshorti i ka krijuar këto pasuri monetare me kursimet e mbajtura në bankë nga pagesat e kryera në këtë llogari nga viti 2005 e në vazhdim, nga institucione të ndryshme, por edhe prej derdhjeve *cash* të bashkëshortit në këtë llogari, burimi i të cilave nuk është i njohur.

3.10 Obligacione në vlerën 1,250,000 (një milion e dyqind e pesëdhjetë mijë) lekë, të emetuara në datën 23.4.2015, në “Alpha Bank”, krijuar me kursime nga të ardhurat, me titullar z. E. P..

3.11 Pas hetimit të llogarive bankare duket se kjo pasuri është krijuar nga kursimet e mbajtura (prej vitit 2009) në llogarinë në euro të subjektit dhe bashkëshortit në vlerën 18,640 (tetëmbëdhjetë

²² Dosja ILDKPKI (aneks 4/4) vërtetim me nr. ***prot., datë 5.7.2017, nga BKT-ja.

²³ Dosja ILDKPKI (aneks 4/5).

²⁴ Dosja e ILDKPKI-së (aneks 4/2) vërtetim blerje Obligacion Thesari në “Raiffeisen Bank”, datë emetimi 23.4.2015, vlera nominale 655,902 lekë.

mijë e gjashtëqind e dyzet) euro ose 2,565,796 (dy milionë e pesëqind e gjashtëdhjetë e pesë mijë e shtatëqind e nëntëdhjetë e gjashtë) lekë, e cila ka burim të ardhurat e transferuara nga GTZ-ja, Këshilli i Europës dhe fondacioni “***”.

3.12 Depozitë me vlerë 2,000,000 (dy milionë) lekë me nr. ***, në “Intesa Sanpaolo Bank”, më 31.1.2014, e krijuar nga të ardhurat nga paga dhe përkthimet, me titullar z. E. P..

3.13 Nga hetimi i llogarive rezultoi se pjesërisht kjo depozitë është krijuar nga depozitime *cash* (përkatësisht 800,000 lekë derdhje *cash*), të kryera nga bashkëshorti gjatë vitit 2011 – 2012 dhe pjesërisht nga kursimet në bankë nga të ardhurat nga Ministria e Drejtësisë.

3.14 Depozitë me vlerë 2,000,000 (dy milionë) lekë me nr. ***, në “ProCredit Bank”, krijuar prej datës 12.5.2013 nga të ardhurat nga paga, me titullar z. E. P..

3.15 Nga hetimi i llogarive bankare rezultoi se kjo depozitë është krijuar nga kursimet prej pagës së bashkëshortit pranë GIZ.

3.16 Në përfundim të hetimit administrativ, rezulton se për krijimin e këtyre pasurive, bashkëshorti i subjekti të rivlerësimit ka bërë hera-herës derdhje *cash* në llogaritë e tij bankare (veçanërisht në “Raiffeisen Bank”), për të cilat nuk njihet burimi i tyre. Këto pasuri janë krijuar nga të ardhurat e subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortit të saj, për të cilat subjekti ka detyrimin të provojë burimin e ligjshëm të tyre në kuptim të pikës 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës, nga ku rezultuan me balancë negative në vlerën (-) 2,408,424 lekë²⁵ (për më shumë referojuni analizës financiare të Komisionit).

3.17 Komisioni i kaloi subjektit të rivlerësimit, në bazë të nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, barrën e provës për të provuar me dokumentacion ligjor burimin e krijimit të pasurive, të krijuara nga derdhjet *cash* në llogaritë bankare të bashkëshortit të subjektit dhe ligjshmërinë e tyre.

3.17.1 Lidhur me burimin e ligjshëm të të ardhurave në kuptim të pikës 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës, për krijimin e pasurisë monetare në vlerën 21,711,962 (njëzetë e një milion e shtatëqind e njëmbëdhjetë mijë e nëntëqind e gjashtëdhjetë e dy) lekë, subjekti i ka kaluar barra e provës së bashku me analizën financiare për vitet 2003 – 2016, e pasqyruar më poshtë në këtë vendim.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit pas kalimit të barrës së provës

3.18 Në shpjegimet e saj, subjekti sqaron derdhjet *cash* nga bashkëshorti në “Raiffeisen Bank”:

- **para martese:** nuk e kujton me detaje burimin e secilës derdhje, por duke qenë se të ardhurat e tij si nga paga, ashtu edhe nga shërbimet e përkthimit për subjekte vendase apo të huaj, bursat e përfituara nga institucione akademike apo huaja e familjarëve të tij janë marrë *cash* edhe derdhjet e parave në bankë e kanë burimin nga këto të ardhura *cash*;
- **pas martese:** burimi i depozimit të parave *cash* në vitin 2007 janë nga të ardhurat nga përkthimet, guidat apo mësimdhënia, të ardhura të cilat janë deklaruar në DPV-në e vitit 2007 si të ardhura të përfituara *cash*, ndërsa burimi i depozimit të parave *cash* në vitin 2011 janë nga të ardhurat *cash* nga përkthimet e deklaruara në pikat 13, 14 dhe 15 të DPV-së së vitit 2011.

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në raport me faktet dhe me ligjin e zbatueshëm

3.19 Në vlerësim të shpjegimeve të subjektit rezulton se ajo nuk përcjell dokumentacion apo sqarime të detajuara për secilën nga derdhjet *cash* në “Raiffeisen Bank”. Në përmbledhje të shpjegimeve të saj rezulton se për derdhjet *cash* në “Raiffeisen Bank” nuk provohet me dokumentacion burimi i tyre, ndërsa në lidhje me derdhjet *cash* në “Intesa Sanpaolo Bank”, pas

²⁵ Shuma prej 550,000 lekë pranë Intesa SanPaolo Bank dhe shuma prej 1,858,424 lekë pranë Raiffeisen Bank

shpjegimeve duket se vetëm 550,000 (pesëqind e pesëdhjetë mijë) lekë janë derdhje *cash* (jo 800,000 lekë), me burim të paprovuar nga subjekti.

3.20 Lidhur me burimin e ligjshëm të të ardhurave në kuptim të pikës 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës, për krijimin e pasurisë monetare në vlerën 21,711,962 (njëzetë e një milion e shtatëqind e njëmbëdhjetë mijë e nëntëqind e gjashtëdhjetë e dy) lekë, situatën negative financiare si dhe qëndrimi i Komisionit, ndodhen më poshtë në këtë vendim, tek analizën financiare për vitet 2003 – 2016.

4. Automjet tip “Volkswagen Tiguan”, me targa TR ***, viti i prodhimit 2009, në bashkëpronësi me bashkëshortin, sipas Kontratës së Shitjes datë 13.11.2013. Vlera: 10,000 (dhjetë mijë) euro, blerë me kursimet e saj dhe të bashkëshortit.

4.1 DPSHTRr-ja²⁶ konfirmon në emër të subjektit të rivlerësimit dhe të z. E. S. P. automjetin e mësipërm tip “Volkswagen Tiguan”.

4.2 Subjekti deklaron blerjen e pasurisë në DPV-në e vitit 2013 dhe në deklaratën *Vetting* me burime: (a) të ardhurat e krijuara nga shitja e automjetit²⁷ tip “Volkswagen Golf”; (b) të ardhura të sajat dhe të bashkëshortit për vitin 2013 dhe kursimet në vite.

4.3 Subjekti deklaron se vlera e mbetur e burimit (3,000 euro) është siguruar nga të ardhurat e vitit 2013 dhe kursimeve në vite, duke qënë se subjekti nuk ka deklaruar kursime në vitin 2012, në analizë janë llogaritur kursimet e mundshme të vitit 2013 deri në datën e blerjes së pasurisë (13.11.2013).

4.4 Nga analiza ka rezultuar se subjekti ka pasur mundësi financiare për krijimin e pasurisë së luajtshme, sipas deklaramit të saj.

5. Gjetje të tjera

5.1 DPPP-ja,²⁸ me shkresën datë 19.2.2019, ka raportuar transaksione bankare, si më poshtë:

- a) tërheqje e shumës prej 1,235,000 (një milion e dyqind e tridhjetë e pesë mijë) lekësh në llogarinë në “ProCredit Bank”, më 17.4.2015, nga subjekti i rivlerësimit me anë të Prokurës së Posaçme, për llogari dhe në emër të vëllait të saj, z. E. F. Q.;
- b) depozitimi *cash* i shumës prej 2,005,000 (dy milionë e pesë mijë) lekësh, nga subjekti në llogarinë bankare në BKT, të vëllait të saj, z. E. F. Q., më 7.7.2015. Burimi i të ardhurave të subjektit të rivlerësimit është deklaruar nga “biznesi”.

5.1.1 Në lidhje me transaksionin bankar të mësipërm në pikën (5.1/a), subjekti i rivlerësimit sqaron²⁹ se me anë të një Prokurë të Përgjithshme³⁰ datë 1.1.2014, vëllai i saj (E. Q.³¹) i ka dhënë të drejta dhe kompetenca të plota të kryejë të gjitha veprimet e nevojshme juridike për administrimin e pasurive të tij të luajtshme dhe të paluajtshme, kudo ku ato të jenë të regjistruara apo ato që mund të fitojë në të ardhmen.

5.1.2 Bazuar në deklaramet e subjektit, në shkurt të vitit 2015, vëllai i saj ka ardhur në Shqipëri, duke sjellë me vete shumën 780,000 (shtatëqind e tetëdhjetë mijë) lekë (kursime nga të ardhurat personale nga puna e tij), të cilat ia ka dhënë subjektit, që t’i investonte në emër të tij në obligacionet e qeverisë shqiptare.

²⁶Shihni shkresën nr. *** prot., datë 15.2.2019 dhe shkresën me nr. *** prot., datë 18.2.2019, nga DPSHTRr-ja.

²⁷ Kontrata e Shitjes me nr. *** rep., nr. *** kol., datë 9.10.2013, e automjetit tip “Volkswagen Golf”, e cila është lidhur midis shitësve E. dhe Fjoralba Priti dhe blerës z. F. F. Q.(vëllai i subjektit), në vlerën 7,000 (shtatë mijë) euro.

²⁸ Shihni shkresën me nr. *** prot., datë 19.2.2019, nga DPPP-ja.

²⁹ Shihni përgjigjen e pyetësorit, datë 5.5.2020 (pyetja 2).

³⁰ Shihni Prokurën e Përgjithshme me nr.*** rep., nr. *** kol., datë 1.1.2014 (përcjellë me përgjigjet e pyetësorit datë 5.5.2020).

³¹ Nga sistemi *TIMS* duket se z. E. Q. rezultoi të ketë qënë në Shqipëri për lëshimin e prokurës së përgjithshme.

5.1.3 Nga sistemi *TIMS* rezulton se z. E. Q. ka ardhur në Shqipëri më 21.2.2015, por nuk provohet me ndonjë mënyrë dhënia e shumës prej 780,000 (shtatëqind e tetëdhjetë mijë) lekësh nga z. E. Q. drejt subjektit të rivlerësimit.

5.1.4 Komisioni i kërkoi subjektit të provojë me dokumentacion ligjor shpjegimet në lidhje me dhënien e shumës prej 780,000 (shtatëqind e tetëdhjetë mijë) lekësh nga vëllai i saj.

5.1.5 Subjekti sqaron se në datën 17.4.2015 është paraqitur në “ProCredit Bank” dhe ka derdhur në llogarinë e vëllait të saj shumën prej 780,000 (shtatëqind e tetëdhjetë mijë) lekësh, duke i kërkuar punonjëses së bankës të aplikojë në ankandin e obligacioneve të datës 21.4.2015. Subjekti sqaron, ndër të tjera, se pasi ka aplikuar për këtë veprim³², ka konstatuar se “ProCredit Bank” nuk ofronte shërbimin për pjesëmarrje në ankandin e obligacioneve nga klientët individë (ofronte aplikim vetëm për bono thesari) dhe ky aplikim mund të bëhej në banka të tjera të nivelit të dytë. Në këto kushte, subjekti ka tërhequr tërë shumën prej 2,012,000 (dy milionë e dymbëdhjetë mijë) lekësh, që vëllai i saj kishte në “ProCredit Bank”. Për të provuar deklarinë e saj, subjekti ka përcjellë bashkë me përgjigjet e pyetësorit, kopje të vërtetimit për depozitë bankare me afat në vlerën 1,166,779 (një milion e njëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e shtatëqind e shtatëdhjetë e nëntë) lekë, e hapur më 5.1.2009 dhe me maturim më 5.11.2011, me titullar z. E. Q.. Megjithatë, dokumentacioni i përcjellë i përket periudhave më të hershme se transksioni bankar i kryer nga subjekti. Sipas vërtetimit, depozita maturohet në datën 5.11.2011, ndërsa veprimet e kryera nga subjekti janë kryer në prill të vitit 2015. Në këtë mënyrë është e pamundur të kuptohet nëse këto fonde kanë qenë ende në depozitë në prill të vitit 2015 apo janë tërhequr më herët.

5.1.6 Komisioni i ka kërkuar subjektit të provojë me dokumentacion ligjor shumën e mësipërme dhe tërheqjen e shumës prej 2,012,000 (dy milionë e dymbëdhjetë mijë) lekësh nga llogaria bankare “ProCredit Bank” të vëllait të saj, në datën 17.4.2015.

5.1.7 Subjekti shpjegon se është paraqitur në BKT po në datën 17.4.2015, për të paraqitur aplikimin për obligacione në ankandin e datës 21.4.2015. Duke qenë se veprimi i regjistrimit të prokurës së lëshuar nga vëllai i saj kishte një procedurë të tillë, që kërkonte miratim nga sektori juridik i “BKT-së, ky veprim nuk mund të kryhej brenda datës 17.4.2015.

Në këto kushte, mbi porosinë e vëllait³³ subjekti deklaroi se ka mbajtur në banesë paratë e tij nga prilli deri në korrik të vitit 2015 (datë në të cilën janë derdhur lekët).

5.1.8 Nga hetimi administrativ i Komisionit u evidentua se me shkresën e ardhur nga BKT-ja³⁴ në datën 7.7.2015 është kryer depozitimi *cash* i vlerës prej 2,005,000 (dy milionë e pesë mijë) lekë në llogarinë bankare në BKT të z. E. Q..

Gjithashtu, u evidentua se në të njëjtën datë (7.7.2015), subjekti i rivlerësimit me anë të Prokurës së Posaçme ka bërë kërkesë³⁵ për prishjen e kontratës së depozitës bankare 5-vjeçare në BKT, në emër të vëllait të saj, z. E. F. Q., në shumën prej 1,214,000 (një milion e dyqind e katërbëdhjetë mijë) lekësh dhe ka bërë kalimin e kësaj shume në obligacione 10-vjeçare.

5.1.9 Nga hetimi i llogarisë bankare në BKT u evidentua se më 9.7.2015, në emër të z. E. Q. janë blerë obligacione në shumën prej 3,200,000 (tre milionë e dyqind mijë) lekësh.

5.1.10 Mbështetur në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni i kaloi subjektit të rivlerësimit barrën e provës për të provuar lidhur me konstatimet dhe problematikat e hasura nga Komisioni për këtë pasuri.

³² Me përgjigjet e pyetësorit datë 5.5.2020 është përcjellë kopje e vërtetimit të bllokimit të shumës për të aplikuar në ankandin e BOA datë 21.4.2015.

³³ Është përcjellë kopje e mandatit të depozitimit nga subjekti me përgjigjet e datës 5.5.2020.

³⁴ Shihni shkresën me nr. *** prot., datë 1.3.2019, nga BKT-ja.

³⁵ Shihni kërkesën për prishjen e kontratës së depozitës bankare, në BKT, më 7.7.2015.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit pas kalimit të barrës së provës

5.1.11 Subjekti sqaron se gjatë pyetësorëve i ka shpjeguar Komisionit në lidhje me konstatimet dhe ka përcjellë një fotokopje të deklaratës³⁶ së vëllait të saj, z. E. Q., datë 18.6.2020, në të cilën ai pohon se ka sjellë nga Gjermania në shkurt të vitit 2015 shumën prej rreth 777,000 (shtatëqind e shtatëdhjetë e shtatë mijë) lekësh, për të cilën ka kërkuar që ajo ta derdhë në llogarinë bankare të tij.

5.1.12 Subjekti sqaron se nga të dhënat e “ProCredit Bank”, të nxjerra në datën 18.8.2020 konfirmohet çdo shpjegim i dhënë prej saj. Llogaria është hapur nga z. E. Q. më 29.10.2003 si depozitë kursimi në vlerën 900,000 (nëntëqind mijë) lekë. Nga të dhënat e llogarisë nr. ***, të “ProCredit Bank”, hapur më 29.10.2003 rezulton se në datën 5.1.2009 kanë ndryshuar të dhënat e llogarisë së kursimit, e cila ishte në vlerën 1,240,497 (një milion e dyqind e dyzet mijë e katërqind e nëntëdhjetë e shtatë) lekë në llogarinë e kursimit nr.*** pranë po të njëjtës bankë. Llogaria rrjedhëse pranë kësaj banke, që mbështet llogarinë e depozitës së kursimit me nr. *** është llogaria nr. ***, me datë hapjeje 5.1.2009, në të njëjtën shumë 1,240,497 (një milion e dyqind e dyzet mijë e katërqind e nëntëdhjetë e shtatë) lekë.

5.1.13 Nga lëvizjet në llogarinë nr.*** është e qartë se më 17.4.2015 banka ka pasqyruar 8 veprime: (1), (2), (3) mbyllje e parakohshme e depozitës me afat me tre veprime të sistemit të bankës; (4) depozitimi nga subjekti i shumës prej 777,000 (shtatëqind e shtatëdhjetë e shtatë mijë) lekësh; (5) pagesë komisioni në vlerën 2,000 (dy mijë) lekë për bllokim fondesh për BTH (bono thesari) në BOA me transfertë dhe fondet totale të disponueshme kanë qenë në vlerën 2,010,985.91 (dy milionë e dhjetë mijë e nëntëqind e tetëdhjetë e pesë e nëntëdhjetë e një cent) lekë; (6) anulim transaksioni për depozimin në llogarinë rrjedhëse të shumës 777,700 (shtatëqind e shtatëdhjetë e shtatë mijë e shtatëqind) e cila është debituar, pra kthyer depozituesit; (7) anulim i veprimit për pagimin e komisionit prej 2,000 lekësh për bllokim fondesh për bono thesari në BOA; (8) tërheqje nga llogaria rrjedhëse e shumës prej 1,235,000 (një milion e dyqind e tridhjetë e pesë mijë) lekësh.

5.1.14 Vlera totale e shumave të tërhequra në datën 17.4.2015 ka qenë 2,012,000 (dy milionë e dymbëdhjetë mijë) lekë, vlerë kjo që provohet se është e njëjta me atë të depozituar prej saj, në BKT, më 7.7.2020.

5.1.15 Veprimet e mësipërme janë kryer në emër e për llogari të vëllait, z. E. Q., sipas Prokurës së Përgjithshme, që i është përcjellë Komisionit dhe gjithashtu janë kryer duke tërhequr paratë *cash* nga “Procredit Bank”, për shkak se data e fundit e aplikimit për blerje obligacionesh në bankat që e ofronin këtë shërbim ishte data 17.4.2015, duke qenë se data e ankandit ishte 21.4.2015. Transferimi me transaksion bankar në llogarinë e vëllait të saj, z. E. Q., në një bankë tjetër të nivelit të dytë, që e ofronte këtë shërbim e ku ai kishte llogari bankare ishte i pamundur në një hark kohor të shkurtër, brenda ditës dhe brenda orarit kur bankat e ofronin këtë shërbim.

5.1.16 Në lidhje me veprimin e blerjes së obligacioneve në datën 21.4.2015, nuk është arritur të kryhet në datën 17.4.2015, pasi nuk kishte prokurë të regjistruar në BKT. Për të njëjtën arsye, në këtë datë nuk është depozituar shuma e parave të tërhequra *cash* nga “ProCredit Bank”.

5.1.17 Subjekti ka paraqitur, në vijim të shpjegimeve të saj, një deklaratë noteriale të datës 20.6.2020, ku z. E. Q. shprehet lidhur me problematikat e evidentuara nga Komisioni në lidhje me këtë çështje dhe bashkëlidh vërtetim lidhur me të ardhurat e tij.

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në raport me faktet dhe me ligjin e zbatueshëm

5.1.18 Në zbatim të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar, subjekti i

³⁶ Shihni deklaratën e datës 18.6.2020 (konfirmuar me vulë apostile), si të dhënat mbi të ardhurat nga punësimi i të vëllait të subjektit në vitet 2014 dhe 2015 të konfirmuara nga punëdhënësi dhe me vulë apostile.

rivlerësimit duhet të deklaronte brenda datës 31 mars të çdo viti, gjendjen deri më 31 dhjetor të vitit paraardhës të interesave private, brenda dhe jashtë territorit të Shqipërisë, burimet e krijimit të tyre, si dhe të detyrimeve financiare: (a) pasuritë e paluajtshme dhe të drejtat reale mbi to sipas Kodit Civil [...]”. **Subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar këto veprime financiare të kryera prej saj dhe, për pasojë, ato i janë shmangur edhe kontrollit edhe verifikimit lidhur me ligjshmërinë e burimit të tyre.**

5.1.19 Po ashtu, subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar as në deklaratën *Vetting* Prokurën e Përgjithshme³⁷ të datës 1.1.2014, që vëllai i saj, z. E. Q., i ka dhënë të drejta dhe kompetenca të plota të kryejë të gjitha veprimet e nevojshme juridike për administrimin e pasurive të tij të luajtshme dhe të paluajtshme, kudo ku të jenë të regjistruara apo ato që mund të fitojë në të ardhmen.

5.1.20 Në vlerësim të fakteve dhe dokumenteve të mbledhura gjatë hetimit dhe deklarimeve të subjektit krijohet bindja se subjekti i rivlerësimit ka dashur të fshehtë veprimet e kryera më sipër, duke i përjashtuar ato nga hetimi dhe verifikimi që kryen ILDKPKI-ja, por edhe Komisioni gjatë procesit të rivlerësimit kalimtar, duke bërë kështu deklaram të pamjaftueshëm të pasurisë në pronësi, posedim apo përdorim të saj.

5.2 Ministria e Drejtësisë³⁸ vendos në dispozicion listën e veprimeve (akteve noteriale) për periudhën 1.3.2013 – 8.3.2019, të kryera nga subjekti i rivlerësimit, bashkëshorti dhe vëllai i saj E. Q., nga ku konstatohet se:

i. Subjekti i rivlerësimit, znj. Fjoralba Prifti në datën 17.12.2013 ka lidhur në zyrën noteriale të znj. A. H. (Sh.), Kontratën e Huapërdorjes me nr. *** rep., nr. *** kol., datë 17.12.2013, (me nr. shërbimi ***).

ii. Z. E. F. Q., në zyrën noteriale të znj. A. H. (Sh.), ka kryer veprimet noteriale:

- a) datë 9.6.2007, lëshim i Prokurës së Përgjithshme me nr. *** rep., nr. ***kol.;
- b) datë 24.12.2015, lëshim i Prokurës së Posaçme me nr. *** rep., nr. *** kol.;
- c) datë 19.8.2018, Revokim Prokure me nr. *** rep., nr. *** kol.

iii. Z. E. F. Q., në datat 20.7.2013, 7.8.2013 dhe 21.8.2015 në zyrën noteriale të z. V. Gj. M. ka lidhur 3 Kontrata të Shitjes së Pasurive të Paluajtshme. Noter V. Gj. M.³⁹ vërteton kontratat e mëposhtme të shitjes:

- a) Kontratën e Shitjes me nr. ***, datë 20.7.2013, për pasurinë e paluajtshme apartament banimi me nr. pasurie ***, me sip. 71,24 m², që ndodhet në Shëngjin, në vlerën 4,100,100 (katër milionë e njëqind mijë e njëqind) lekë, me palë shitëse shoqërinë “****” sh.p.k. dhe palë blerëse E. Q.;
- b) Kontratën e Shitjes me nr. ***, datë 7.8.2013, për pasurinë e paluajtshme apartament banimi me sip. 65,5 m² dhe verandë me sip. 23,7 m², me nr. pasurie ***, që ndodhet në ***, Lezhë, në vlerën 3,930,000 (tre milionë e nëntëqind e tridhjetë mijë) lekë, me palë shitëse F. B. dhe palë blerëse E. Q.;
- c) Kontratën e Shitjes me nr. ***, datë 21.8.2015, për pasurinë e paluajtshme parking, me sip. 13,25 m², me nr. pasurie ***, që ndodhet në Shëngjin, në vlerën 140,000 (njëqind e dyzet mijë) lekë, me palë shitëse shoqërinë “****” sh.p.k. dhe palë blerëse E. Q..

iv. Bashkëshorti i subjektit (E. S. P.), në datën 22.5.2018 ka lidhur Kontratë Shitje Pasuri e Paluajtshme me nr. *** rep., nr. *** kol., në zyrën noteriale të znj. R. A. D..

5.2.1 Nga hetimi i Komisionit, me shkresën me nr. *** rep., datë 15.6.2020, e ardhur nga notere R. D. është vënë në dispozicion kontrata përkatëse e shitjes, ku përcaktohet se z. E. P. ka blerë nga

³⁷ Shihni Prokurën e Përgjithshme me nr.*** rep., nr. *** kol., datë 1.1.2014 (përcjellë me përgjigjet e pyetësorit datë 5.5.2020).

³⁸ Shihni shkresën nr. *** prot., datë 25.3.2019, nga Ministria e Drejtësisë.

³⁹ Shihni shkresën me nr. *** prot., datë 8.5.2020, nga noter V. Gj. M. (bashkëngjitur 3 Kontratat e Shitblerjes së Pasurive të Paluajtshme).

znj. T. T. pasurinë e paluajtshme të llojit garazh, me sip. 14.71 m², me nr. pasurie ***, me vendndodhje Blv. “Zhan D’Ark”, Tiranë dhe me çmim shitje 950,000 (nëntëqind e pesëdhjetë mijë) lekë.

5.2.2 Në DPV-në e vitit 2018 subjekti i rivlerësimit deklaroi pasurinë e paluajtshme garazh, blerë nga bashkëshorti E. P. nga kursimet në llogarinë personale në “Credins Bank” në vlerën 950,000 (nëntëqind e pesëdhjetë mijë) lekë.

5.2.3 Nga hetimi i llogarive të tij në “Credins Bank” konfirmohet kryerja e pagesës për blerjen e pasurisë garazh në llogarinë e noteres R. D. me fondet e bashkëshortit, të cilat ekzistonin gjendje në këtë llogari.

5.2.4 Nga hetimi administrativ i Komisionit dhe nga verifikimi në sistemin *TIMS* për z. E. F. Q. rezulton se për Kontratat e Shitjes së mësipërme me nr. ***, datë 7.8.2013 dhe nr. ***, datë 21.8.2015, z. E. F. Q. nuk rezulton të ketë qenë në Shqipëri në datat e caktuara për firmosjen e këtyre kontratave dhe nuk rezulton të ketë lëshuar prokurë të tretë për firmosjen e tyre (sipas sistemit *TIMS*, z. E. Q. ka dalë nga Shqipëria më 22.7.2013 dhe ka hyrë në Shqipëri më 23.12.2013, ndërsa në datën 25.7.2015 rezulton të ketë hyrë në Shqipëri dhe në datën 14.8.2015 rezulton të ketë dalë nga Shqipëria).

5.2.5 Në bazë të nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit të rivlerësimit i kaloi barra e provës për të provuar lidhur me problematikat e mësipërme, të cilat janë konstatuar nga hetimi i Komisionit.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit pas kalimit të barrës së provës

5.2.6 Në lidhje me problematikat e pasqyruara në pikën (iii) për Kontratat Noteriale të lidhura nga i vëllai E. F. Q., në datat 20.7.2013, 7.8.2013 dhe 21.8.2015 në zyrën noteriale të z. V. Gj. M., subjekti sqaron dhe evidenton se nuk ka qenë palë në këto kontrata.

Subjekti sqaron gjithashtu se pasi kishte biseduar me të vëllanë në lidhje me këtë çështje, ai i shpjegoi se kontratat noteriale të sipërpërmendura, të përcjella bashkë me rezultatet e hetimit janë nënshkruar prej tij në një periudhë kur ka qenë në Shqipëri, në prezencë të përfaqësuesit të palës shitëse, në prezencë të tij dhe të noterit. Nënshkrimi në dokumente është autentik i tij. Data “7.8” e aktit noterial me nr. ***, datë 7.8.2013 është me shtesa dhe korrigjime të pakonfirmuara nga palët në kontratë.

Vëllai i ka shpjeguar se në kuptim të nenit 107 të ligjit nr. 110/2018, “Për noterinë” me titull “Ndreqja e gabimeve në aktet dhe veprimet noteriale”, nuk ka interes për të kërkuar nga noteri ndreqjen e gabimit të datës dhe muajit në aktin noterial, pasi përcaktimi i një date me korrigjime në aktin noterial të pakundërshtuar nga palët dhe që ka sjellë pasoja për to, nuk vlerësohet se cenon përmbajtjen thelbësore të aktit. Edhe akti noterial me nr. ***, datë 21.8.2015, sipas shpjegimeve të vëllait është lidhur para noterit në prezencë të tij dhe të përfaqësuesit të shitësit.

Data “21” e aktit noterial me nr. ***, datë 21.8.2015 është e plotësuar me shkrim dore nga noteri, ndërsa muaji gusht është një muaj në të cilin vëllai i subjektit ka qenë në Shqipëri. Edhe për këtë akt, ai ka shpjeguar se në kuptim të nenit 107 të ligjit nr. 110/2018, “Për noterinë” me titull “Ndreqja e gabimeve në aktet dhe veprimet noteriale” nuk ka interes për të kërkuar nga noteri ndreqjen e gabimit të datës në aktin noterial, pasi përcaktimi i saj i gabuar në aktin noterial të pakundërshtuar nga palët dhe që ka sjellë pasoja për to, nuk vlerësohet se cenon përmbajtjen thelbësore të aktit. Në thelb, hartimi i aktit noterial është përgjegjësi e noterit, i cili i përpilon dhe mban përgjegjësi për çdo gabim apo pasaktësi që ka në to.

5.2.7 Në lidhje me çështjen se duket e dyshimtë blerja e një apartamenti të dytë nga vëllai i saj në Shëngjin, subjekti shpjegon se ai ka sqaruar më së miri në deklaratën e datës 18.6.2020 se fokusi i investimeve të tij para se të merrte nënshkrimin gjermane në vitin 2016 ishte në Shqipëri dhe pas kësaj periudhe, investimet e tij janë fokusuar në Gjermani. Ky shpjegim është i qartë dhe

mbështetet nga hetimi i Komisionit, sipas të cilit pas marrjes së nënshtetësisë gjermane në vitin 2016, pavarësisht se ka të ardhura të konsiderueshme në Gjermani, vëllai i saj E. Q. nuk i ka fokusuar më investimet e tij në Shqipëri.

5.2.8 Subjekti ka shpjeguar se nisur nga fakti që në këtë periudhë vëllai i saj ka qenë me pushime në Shqipëri, ai ka përpiluar një deklaratë noteriale me nr. *** rep., nr. *** kol., datë 24.8.2020 me anë të së cilës shpjegon problematikat e ngritura nga Komisioni.

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në raport me faktet dhe me ligjin e zbatueshëm

5.2.9 Në zbatim të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar, subjekti i rivlerësimit duhet të deklaronë brenda datës 31 mars të çdo viti gjendjen deri më 31 dhjetor të vitit paraardhës të interesave private, brenda dhe jashtë territorit të Shqipërisë, burimet e krijimit të tyre, si dhe të detyrimeve financiare si: (a) *pasuritë e paluajtshme dhe të drejtat reale mbi to, sipas Kodit Civil [...]’*. Subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar këto veprime financiare të kryera prej saj dhe, për pasojë, ato i janë shmangur edhe kontrollit edhe verifikimit lidhur me ligjshmërinë e burimit të tyre.

5.2.10 Në vlerësim të fakteve dhe dokumenteve të mbledhura gjatë hetimit dhe deklarimeve të subjektit krijohet bindja se subjekti i rivlerësimit ka dashur të fshehtë veprimet e kryera më sipër duke i përjashtuar ato nga hetimi dhe verifikimi që kryen ILDKPKI-ja, por edhe Komisioni gjatë procesit të rivlerësimit kalimtar, duke bërë kështu deklarin të pamjaftueshëm të pasurisë në pronësi, posedim apo përdorim të saj.

5.2.11 Në vijim të kësaj analize dhe në vlerësim të të gjitha fakteve të konstatuara në rubrikën “Gjetje të tjera”, Komisioni konstaton se shpjegimet që subjekti i rivlerësimit ka dhënë në lidhje me marrëdhënien e saj me këto pasuri, janë hera herës kontradiktore e të paarsyeshme, ato nuk bindin për vërtetësinë e deklarinimit të saj, por ngrenë dyshime të forta për paraqitjen e rrethanave të rreme, të cilat tentojnë të fshehin nga kontrolli apo verifikimi një marrëdhënie të një natyre tjetër, që është ajo e pronësisë me këto pasuri.

5.2.12 Subjekti i rivlerësimit konstatohet se nuk ka deklaruar Prokurën e Posaçme të vitit 2015, as Prokurën e Përgjithshme të vitit 2007 dhe as një sërë veprimesh të kryera në zbatim të saj në deklaratën e pasurisë *Vetting*, në përputhje me detyrimin kushtetues të parashikuar në pikën 5, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës edhe atë ligjor të parashikuar në shtojcën nr. 1 të ligjit nr. 84/2016, por as në DPV për të krijuar kështu bindjen se deklarimet ishin koherente dhe të qëndrueshme.

5.2.13 Në përfundim të analizës së mësipërme, Komisioni arrin në përfundimin se subjektit i rivlerësimit është përpjekur të mos deklarojë veprimet e kryera prej saj, duke i fshehur pas veprimeve të kryera për shkak të një prokure dhe më pas të deformatojë faktet që tregojnë natyrën e marrëdhënies së saj me këtë pasuri, duke u gjendur në këtë mënyrë para parashikimeve të pikës 5, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës dhe të germës “c”, të pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84.2016, që lidhen me fshehjen e pasurisë⁴⁰.

5.3 Nga hetimi administrativ i Komisionit, me shkresat e ardhura nga DPSHTRr-ja⁴¹, konfirmohet se subjekti dhe bashkëshorti kanë në pronësi automjetin tip “Volkswagen Golf”, viti i prodhimit 2017, me targa ***, blerë nga shoqëria “***” sh.p.k., në vlerën 19,279,14 (nëntëmbëdhjetë mijë e dyqind e shtatëdhjetë e nëntë e katërmëdhjetë cent) euro. Subjekti e ka deklaruar edhe në DPV-në e vitit 2018 pasurinë e luajtshme automjetin tip “Volkswagen” Golf, në vlerën 25,000 (njëzet e pesë mijë) euro.

⁴⁰ Ky arsyetim vjen në harmoni edhe me vendimin nr. ***, datë 26.6.2020, të KPA-së.

⁴¹ Shihni shkresën nr. *** prot., datë 15.2.2019 dhe shkresën nr. *** prot., datë 18.2.2019, nga DPSHTRr-ja.

5.3.1 Si burim i kësaj pasurie është deklaruar se kanë shërbyer kursimet e bashkëshortit të mbajtura në llogarinë bankare në “ProCredit Bank”. Nga hetimi i llogarive bankare të bashkëshortit, konfirmohet mbyllja e depozitës së tij dhe tërheqja e vlerës prej 2,000,000 (dy milionë) lekë nga llogaria në “ProCredit Bank”, më 12.5.2018. Bashkëshorti ka tërhequr edhe shumën prej 600,000 (gjashtëqind mijë) lekësh në “Alpha Bank” më 22.5.2018, me përshkrimin “për blerje makine” dhe, po ashtu, është tërhequr edhe shuma prej 600,000 (gjashtëqind mijë) lekësh nga llogaria rrjedhëse në BKT, në maj të vitit 2018.

5.4 Referuar deklaramëve periodike ndër vite, kanë rezultuar edhe gjetje të tjera mbi pasuritë e luajtshme (automjete në pronësi të subjektit dhe/ose bashkëshortit):

5.4.1 Në DPV-në e vitit 2006 bashkëshorti i subjektit deklaroi automjetin tip “Ford Fiesta”, prodhim i vitit 1990, në vlerën 2,000 (dy mijë) euro. Pas këtij deklarimi, subjekti nuk deklaroi më për këtë pasuri në deklaramët pasardhëse periodike apo në deklaratën *Vetting*.

5.4.2 Subjekti, e pyetur nga Komisioni⁴², deklaroi se pasuria është shitur te z. F. Q. (babai i subjektit) sipas kontratës me nr. *** kol., datë 4.6.2008, në vlerën 200,000 (dyqind mijë) lekë, automjet që është nxjerrë më pas jashtë përdorimit për shkak të një aksidenti të bërë nga babai i saj.

5.4.3 Nga verifikimi i DPV -ve ka rezultuar se subjekti nuk ka deklaruar shitjen e automjetit në DPV-në e vitit 2008.

5.4.4 Në DPV-në e vitit 2008 subjekti deklaroi automjet tip “Volkswagen Golf” blerë nga shoqëria “****” sh.a., me kontratë datë 23.5.2008, me çmim 14,700 (katërmëdhjetë mijë e shtatëqind) euro. Nuk deklarohet burimi i pasurisë së luajtshme. Deklarohet shitja e këtij automjeti në DPV-në e vitit 2013: “*Shitur sipas kontratës me nr. *** rep., nr. *** kol., në datën 9.10.2013 te F. Q., në vlerën 7,000 euro*”.

5.4.5 Nga hetimi i Komisionit dhe nga mbajtja e korrespondencës me bankat e nivelit të dytë, rezultoi se pjesërisht si burim për këtë pasuri ka shërbyer financimi me kredi nga BKT-ja⁴³ në vlerën 9,700 (nëntëqind mijë e shtatëqind) euro, në datën 5.6.2008. Kjo shumë ka kaluar me transfertë bankare nga llogaria e znj. Fjoralba Prifti, në BKT, te shoqëria “****” sh.p.k., me përshkrimin “Fjoralba Prifti (E. P.) – sa këmbyer ALL në euro dhe kalon në favor të “****” sh.p.k. për likuidim blerje makine (9,700 euro)”. Kjo kredi është shlyer brenda 3 muajve, më 25.9.2008, me derdhje *cash* të vlerës së mbetur (320,000 lekë) nga subjekti në llogarinë e saj në BKT, të cilat nuk duket se janë tërhequr nga ndonjë prej llogarive bankare të tjera të subjektit apo bashkëshortit.

5.4.6 Subjekti deklaroi me përgjigjet e datës 29.6.2020 se shuma është siguruar nga të ardhurat e bashkëshortit, të kursyera nga bursa e marrë nga “****”.

5.4.7 Komisioni hetoi⁴⁴ mbi mundësinë e kursimit të vlerës, me të cilën është likuiduar kredia në datën 25.9.2008, nga ku rezultoi se subjekti ka pasur mundësi të kursejë vlerën e derdhur *cash* (320,000 lekë) në BKT, e përdorur për mbylljen e kredisë, por subjekti nuk ka deklaruar në DPV-në e vitit 2008 burimin e kësaj pasurie (automjet tip “Volkswagen” Golf) dhe marrjen e kredisë në BKT.

5.4.8 Duke u bazuar në analizën financiare (për periudhën 1.1.2008 – 25.9.2008), rezultoi se subjekti dhe bashkëshorti kanë pasur mundësi të blejnë pasurinë e luajtshme (“Volkswagen Golf” në shumën prej 14,700 euro) me kursimet e tyre nga të ardhurat e kësaj periudhe.

6. Analiza financiare për periudhën 2003 – 2016

6.1 Për efekt të pasqyrimin të metodologjisë së ndjekur, Komisioni, në këtë analizë financiare, është bazuar në dokumentacionin e administruar dhe të vënë në dispozicion nga ILDKPKI-ja, deklaratat e interesave pasurore private/vjetore, deklaratat *Vetting*, pyetësorët me përgjigjet e

⁴² Përgjigjet e pyetësorit, datë 23.4.2020.

⁴³ Shkresa me nr.*** prot., datë 1.3.2019, nga BKT-ja (dosja e Komisionit).

⁴⁴ Shihni shkresën me nr. *** prot., datë 1.3.2019, nga BKT-ja.

subjektit, si dhe korrespondenca e Komisionit me institucionet publike dhe jopublike. Analiza financiare e subjektit për periudhën e hetuar, bazohet në:

a) Të ardhurat e ligjshme sipas vërtetimeve për të ardhurat *neto*, dërguar nga institucionet publike për subjektin e rivlerësimit⁴⁵ dhe bashkëshortin, të cilat janë deklaruar dhe për të cilat janë paguar detyrimet tatimore në zbatim të pikës 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës. Deklarimi i të ardhurave të bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit është pasqyruar në detaje në Aneksin 1 dhe 2, dërguar subjektit të rivlerësimit së bashku me rezultatet e hetimit.

b) Të ardhurat nga shitja e automjeteve⁴⁶ sipas deklarimeve periodike vjetore të subjektit, si dhe në dokumentacionin përkatës të përcjellë nga subjekti dhe DPSHTRr-ja.

c) Të ardhurat nga interesat bankare janë përfshirë në analizën financiare sipas nxjerrjes së llogarive bankare të përcjella nga bankat⁴⁷.

d) Për analizimin e shpenzimeve u morën në konsideratë: (1) shpenzimet e jetesës për vitet 2003 – 2016, u bazuan në shpenzimet e përcaktuara në raportin e ILDKPKI-së⁴⁸; (2) shpenzimet për udhëtime jashtë shtetit u analizuan bazuar në të dhënat e sistemit *TIMS*, si dhe në deklarimet e subjektit⁴⁹. Për përlogaritjen e shpenzimeve të udhëtimit janë marrë si referencë vendimi nr. *** (JR), datë 22.5.2019, i KPA-së dhe deklarimet e subjektit. Nuk janë marrë në konsideratë shpenzimet e udhëtimit kur subjekti ka deklaruar udhëtime për qëllime pune⁵⁰, të cilat janë provuar me dokumentacion. Gjithashtu, nuk janë konsideruar shpenzimet e akomodimit për rastet kur subjekti ka deklaruar se është akomoduar te të afërmit dhe e ka provuar me dokumentacion deklarimin e tij. Në rastet e tjera, kur deklarimet e subjektit kanë qenë të pambështetura në dokumentacion provues, shpenzimet e udhëtimit dhe të qëndrimit janë konsideruar mbi bazën e vendimit nr. *** (JR), datë 22.5.2019, të KPA-së; (3) shpenzimet e arredimit⁵¹ u bazuan në deklarimet e subjektit për shpenzimet e apartamentit gjatë pyetësorëve; (4) detyrimet ndaj huamarrësve dhe shoqërisë së ndërtimit “****” sh.a., si dhe shlyerja e tyre, u bazuan në deklarimet e subjektit, të kryera në deklaratat e interesave pasurore private/vjetore, si dhe në dokumentacionin⁵² e depozituar; (5) shpenzimet për blerje automjetesh⁵³ u bazuan në deklarimet vjetore të subjektit, pyetësorët si dhe në dokumentacionin përkatës; (6) shpenzimet e shkollimit të fëmijëve të subjektit u bazuan në vërtetimet e përcjella në Komision;⁵⁴ (7) shpenzime udhëtimi në funksion të detyrës⁵⁵ janë llogaritur shpenzimet e udhëtimeve të kryera nga subjekti për efekt të funksioneve të saj në qytete të tjera, të cilat nuk janë pranë vendbanimit të saj. Për periudhën 2003 – 2013, kur ka shërbyer në Gjykatën e Lezhës, subjekti nuk ka deklaruar vlera shpenzimesh. Deri në këto momente, këto shpenzime janë llogaritur sipas deklarimit të subjektit për koston e udhëtimit (100 lekë) dhe si ditë pune janë konsideruar të gjitha ditët normale të punës, në bazë mujore (20 ditë në muaj dhe 11 muaj në vit). Subjekti nuk arriti të shpjegonte grafikun e punës së saj pranë kësaj gjykate ose shpenzime mesatare mujore, të cilat do të përfshiheshin në analizë; (8) nga maji 2013 – 2016, subjekti ka kryer funksionin e saj në Gjykatën e Shkodrës, ku shpenzimet janë deklaruar nga subjekti dhe konsideruar mbi këto baza nga Komisioni; (9) shpenzimet e interesave të kredive bankare u bazuan në dokumentacionin e përcjellë nga komunikimi shkresor me bankat e nivelit të dytë.

e) Për analizimin e kursimeve *cash* u morën në konsideratë: (1) deklarimet e kryera nga subjekti i rivlerësimit në deklaratat e interesave pasurore private/vjetore dhe përgjigjet në pyetësorët e

⁴⁵ Vërtetim nr. ***, datë 4.10.2016, nga Shkolla e Magjistraturës; vërtetim për pagën *bruto* nga Gjykata e Tiranës; vërtetim nr. ***, datë 21.10.2016, nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë; vërtetim nr. ***, datë 20.10.2016, nga Gjykata e Apelit Shkodër; vërtetim nr. ***, datë 17.1.2017, nga Gjykata Administrative e Apelit; shkresa nr. *** prot., datë 19.3.2019, nga “Credins Bank”; letër nga KE-ja për ndjekje seminari për Shkollën e Magjistraturës datë 31.3.2008 e përcjellë me përgjigjet e pyetësorit datë 23.4.2020 (pyetja 6) dhe shkresë me nr. *** prot., datë 1.3.2019, e BKT-së.

⁴⁶ Shihni shkresën me nr. *** prot., datë 15.2.2019 dhe shkresën me nr. *** prot., datë 18.2.2019, nga DPSHTRr-ja; shihni kontratën e shitblerjes datë 19.10.2018 midis shtetasve F. Q. dhe G. N..

⁴⁷ Dosja ILDKPKI, Aneks 4/19 dhe shkresa me nr. *** prot., datë 20.2.2019, në dosjen e Komisionit.

⁴⁸ Shkresë me nr. *** prot., datë 4.3.2019, nga ILDKPKI-ja.

⁴⁹ Përgjigjet e pyetësorit datë 25.1.2019 dhe përgjigjet e pyetësorit datë 5.5.2020.

⁵⁰ Pyetësori nr.1, datë 25.1.2019 dhe pyetësori i datës 5.5.2020.

⁵¹ Pyetësori datë 8.5.2020, pyetësori nr. 2, datë 16.12.2019 dhe përgjigjet e datës 29.6.2020.

⁵² Aneks 4/6, 4/7, 4/8 në dosjen e ILDKPKI-së, pyetësori nr. 2, datë 16.12.2019.

⁵³ Shkresat nr. *** prot., datë 18.2.2019 dhe shkresë nr. ***, datë 8.2.2019, nga DPSHTRr-ja.

⁵⁴ Vërtetim nga shkolla jopublike “****” përcjellë me përgjigjet e datës 25.1.2019.

⁵⁵ Përgjigje pyetësori datë 23.4.2020.

administruar në dosjen e Komisionit. Bashkëshorti i subjektit deklaroi kursimet në DPV-në e vitit 2008 “*Likuiditete cash në vlerën 300.000 (treqind mijë) lekë dhe 10.500 (dhjetë mijë e pesëqind) euro*”; në DPV-në e vitit 2009 deklaroi “*Likuiditete 200,000 (dyqind mijë) lekë dhe 1,000 (një mijë) euro*” dhe në DPV-në e vitit 2010 deklaroi “*Likuiditete 8,000 (tetë mijë) euro*”. Në analizën financiare këto vlera janë pasqyruar si gjendje të vitit përkatës dhe jo si shtesa të viteve; (2) gjendjen e likuiditeteve në bankë, në fillim dhe në fund të vitit të analizuar, bazuar në të dhënat e pasqyrave të lëvizjeve bankare.

f) Lidhur me pasuritë e krijuara, shpenzimet dhe kursimet e deklaruara u verifikuan dhe u krahasuan përputhshmëria e deklarimeve të subjektit të rivlerësimit në deklaratat e interesave pasurore private/vjetore, në deklaratën *Vetting*, si dhe në aktet e tjera në dosjen e Komisionit.

6.2 Në konkludim të sa më sipër, rezultati i analizës financiare për periudhën 2003 – 2016 është me vlerë negative prej 4,080,186 (katër milionë e tetëdhjetë mijë e njëqind e tetëdhjetë e gjashtë) lekësh. Ky rezultat nuk përfshin të ardhurat e bashkëshortit para martesë (pra, para shkurtit të vitit 2006, si dhe huan për blerjen e pasurisë apartament në Tiranë).

6.3 Në lidhje me të ardhurat e bashkëshortit⁵⁶, në referencë të pikës 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës janë konsideruar të ardhurat, si vijon:

a) janë marrë në konsideratë si të ardhura të ligjshme ato të cilat janë deklaruar dhe provuar me dokumentacion ligjor dhe është vërtetuar pagesa e detyrimit tatimor, të cilat në vlerë totale janë 36,683,904 (tridhjetë e gjashtë milionë e gjashtëqind e tetëdhjetë e tre mijë e nëntëqind e katër) lekë;

b) nuk janë marrë në konsideratë të ardhurat për të cilat nga subjekti nuk është paraqitur dokument provues kontratë apo pagesë në bankë që provon përfitimin e shumës dhe ekzistencën e marrëdhënies së punës, të cilat në vlerë totale janë 2,845,752 (dy milionë e tetëqind e dyzet e pesë mijë e shtatëqind e pesëdhjetë e dy) lekë;

c) nuk janë marrë në konsideratë të ardhurat për të cilat subjekti ka paraqitur dokument⁵⁷ provues kontratë për përfitimin e pagesës dhe ekzistencën e marrëdhënies së punës, ku deklarohet gjithashtu se pagesa e tatimit mbi këto të ardhura është mbajtur në burim, por subjekti nuk ka arritur të konfirmojë se pagesa e tatimit është kryer, të cilat në vlerë totale janë 6,006,958 (gjashtë milionë e gjashtë mijë e nëntëqind e pesëdhjetë e tetë) lekë.

6.4 Në bazë të nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit i kaloi barra e provës për të provuar të kundërtën e rezultatit të hetimit.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit pas kalimit të barrës së provës

6.5 Në vijim të rezultateve të hetimit, subjekti i rivlerësimit ka dhënë shpjegime lidhur me të gjithë zërat që kanë rezultuar problematikë apo kanë sjellë një situatë negative financiare. Në lidhje me të ardhurat e pakonsideruara nga Komisioni si të ardhura të ligjshme në kuptim të pikës 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës, subjekti i rivlerësimit i ka kërkuar Komisionit që në vlerësimin e ligjshmërisë së të ardhurave të deklaruara, për të cilat ka provuar se është në pamundësi të vërtetojë realizimin e tyre apo pagimin e tatimit në burim, të ketë në konsideratë përcaktimet e nenit 32.2 të ligjit nr. 84/2016 dhe t'i konsiderojë të provuara faktet e pretenduara prej saj, për aq kohë sa nuk ka një të dhënë të kundërt që tregon se të ardhurat e deklaruara nuk janë realizuar apo se për to nuk është paguar tatimi në burim.

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në raport me faktet dhe me ligjin e zbatueshëm

6.6 Lidhur me të ardhurat e deklaruara nga personi i lidhur (bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit), për të cilat janë paraqitur si dokument provues kontratë për ekzistencën e

⁵⁶ Për të dhëna të detajuara lidhur me të ardhurat e bashkëshortit, referojuni Aneksit 1 dhe 2 bashkëngjitur.

⁵⁷ Subjekti ka paraqitur dokumentacion nga DRT-ja Tiranë që nuk arrin të vërtetojë pagesën përkatëse dhe se bashkëshorti nuk ka ruajtur dokument për kryerjen e pagesës dhe as punëdhënësi nuk i është përgjigjur kërkesës së saj.

marrëdhënies së punës dhe përfitimin e pagesës, në vlerë totale prej 6,006,958 (gjashtë milionë e gjashtë mijë e nëntëqind e pesëdhjetë e tetë) lekësh, ku deklarohet se pagesa e tatimit mbi këto të ardhura do të mbahet në burim, subjekti nuk ka arritur të konfirmojë se pagesa e tatimit është kryer.

6.7 Dokumentet e mbledhura gjatë hetimit, përmbajnë *indicie* lidhur me faktin e angazhimit profesional të personit të lidhur dhe përfitimit prej tij të të ardhurave në këmbim të këtij angazhimi. Për sa u përket elementeve të tjera thelbësore, siç janë koha apo mënyra e arkëtimit të pagesave (të ardhurave) nga personi i lidhur, si dhe pagesa e tatimit përkatës, arrihet në konkluzionin se ato mbetën në nivelin e pretendimeve të paprovuara. Po ashtu, kjo provë nuk rezultoi të jetë dokumentuar ndonjëherë as në DPV-të e bëra nga subjekti i rivlerësimit ndër vite, duke rrëzuar kështu pretendimin se për efekt të kohës së largët ajo nuk administron/disponon më këto dokumente. Lidhur me këto të ardhura nuk është administruar asnjë dokumentacion provues lidhur me pagimin e detyrimeve tatimore, madje as subjekti nuk ka arritur ta provojë këtë fakt as sot dhe as ndër vite

6.8 Trupi gjykues, në arritjen e këtij konkluzioni, mban në konsideratë edhe parashikimin e pikës 2, të nenit 35, të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar deri në vitin 2003, sipas të cilit personi i lidhur kishte të drejtën t’i kërkonte shoqërisë provën e regjistrimeve lidhur me mbajtjen dhe pagimin e tatimit në burim, e drejtë e cila nuk u provua të jetë ushtruar nga subjekti i rivlerësimit apo personi i lidhur me të, gjatë ekzekutimit të marrëdhënieve të punës ndër vite.

6.9 Shkresa e marrë prej subjektit të rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, por edhe nga Komisioni, nga organet tatimore, nuk provonte kushtin e përcaktuar në pikën 2, të nenit 32, të ligjit nr. 84/2016, pasi sipas organeve tatimore ky informacion nuk gjendej në regjistrat elektronikë (në sistemin informatik) dhe subjekti nuk arriti t’i vërtetojë Komisionit se dokumentacioni provues mbi ligjshmërinë e të ardhurave objekt vlerësimi është zhdukur, ka humbur, nuk mund të bëhet përsëri ose nuk mund të merret në rrugë tjetër dhe se subjekti nuk ndodhet në kushtet e pamundësisë objektive sipas pikës 2, të nenit 32, të ligjit nr. 84/2016.

6.10 Lidhur me të ardhurat e deklaruara nga personi i lidhur (bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit), për të cilat nuk është paraqitur dokument provues, kontratë apo pagesë në bankë që provon përfitimin e shumës dhe/apo ekzistencën e marrëdhënies së punës, të cilat në vlerë totale janë 2,845,752 (dy milionë e tetëqind e dyzet e pesë mijë e shtatëqind e pesëdhjetë e dy) lekë, trupi gjykues vlerëson se mbetet e paprovuar ligjshmëria e këtyre të ardhurave, dhe se Komisioni në vlerësimin e tij nuk mund të mjaftohet vetëm me deklarimin e të ardhurave nga subjekti i rivlerësimit dhe faktin se ato janë deklaruar gjithashtu ndër vite, pasi gjatë hetimit nuk u administrua asnjë dokumentacion provues lidhur me përfitimin e pagesës apo pagimin e detyrimeve tatimore dhe as subjekti nuk ka arritur ta provojë këtë fakt.

6.11 Lidhur me disa shpenzime të pretenduara nga subjekti i rivlerësimit në vijim të shpjegimeve lidhur me rezultatet e hetimit, Komisioni i ka marrë ato në konsideratë në analizën financiare për vitet 2003 – 2016 duke e rishikuar atë. Në përfundim, subjekti i rivlerësimit rezultoi me një situatë negative financiare prej -3,591,317 (tre milionë e pesëqind e nëntëdhjetë e një mijë e treqind e shtatëmbëdhjetë) lekë.

6.12 Në përfundim, trupi gjykues arrin në konkluzionin se të ardhurat e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit në vlerën prej 3,591,317 (tre milionë e pesëqind e nëntëdhjetë e një mijë e treqind e shtatëmbëdhjetë) lekësh (duke marrë në konsideratë vetëm rezultatin negativ të analizës financiare), të cilat kanë shërbyer si burim për krijimin e pasurive në formë monetare ose në tituj qeveritarë, në total në vlerën 21,711,962 (njëzet e një milionë e shtatëqind e njëmbëdhjetë mijë e nëntëqind e gjashtëdhjetë e dy) lekë, si dhe për përballimin e kostove të jetesës dhe shpenzimeve të tjera të deklaruara nga subjekti i rivlerësimit, nuk u provuan nga ajo se përmbushin kriteret e përcaktuara nga pika 3, e nenit D, të Aneksit të Kushtetutës për t’u konsideruar të ardhura të

ligjshme. Trupi gjykues arrin në konkluzionin se pasuritë e fituara janë rrjedhojë e fshehjes së detyrimeve fiskale, dhe për rrjedhojë, në kuptim të dispozitave kushtetuese dhe neneve 30 dhe 33 të ligjit nr. 84/2016, nga kontrolli lidhur me pasuritë e sipërcituara, subjekti i rivlerësimit rezulton të jetë në kushtet e pamjaftueshmërisë së burimeve të ligjshme për t'i justifikuar ato.

6.13 Për rrjedhojë, shuma prej 3,591,317 (tre milionë e pesëqind e nëntëdhjetë e një mijë e treqind e shtatëmbëdhjetë) lekësh nuk mund të konsiderohet si e ardhur e ligjshme në kuptim të pikës 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 30 të ligjit nr. 84/2016, (këtu nuk përfshihet vlera e huasë dhe situata negative financiare e rezultuar para martesë).

Tabela e analizës financiare 2003 – 2016

	Përshkrimi	2003	2004	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016
1	PASURI	700 000	0	435 872	13 007 174	1 135 564	3 441 926	2 311 142	4 478 159	1 803 869	3 808 901	4 170 233	2 193 643	1 856 251	2 481 223
a.	Apartament banimi 132.8 m2 bruto 121.29 m2 neto +vend parkim				12 103 670										
b.	Autoveture Ford Fiesta				247 406		-200 000								
c.	Automjet Volkswagen Golf 14.700 Euro shitur ne 2013 7.000 euro						1 810 783					-981 470			
d.	Automjet Volkswagen Tiguan 13/11/2013 TR34215											1 402 100			
e.	Are 135 m2 e fituar me trashëgimi dhe ne bashkepronësi 4 pronare													0	0
	Automjet Volkswagen AU Golf 7; 25.000 Euro blere ne 24.05.2018														
	Garazh me sip 14,71 m2; blere ne 22.05.2018;														
f.	Shtesa/pakesime likuiditete	700 000	0	435 872	656 098	1 135 564	1 831 143	2 311 142	4 478 159	1 803 869	3 808 901	3 749 603	2 193 643	1 856 251	2 481 223
g.	Total likuiditete	700 000	700 000	1 135 872	1 791 971	2 927 535	4 758 678	7 069 819	11 547 978	13 351 847	17 160 747	20 910 350	23 103 994	24 960 245	27 441 468
2	DETYRIME	0	0	0	5 814 041	-1 450 920	1	0	0	0	0	-727 690	0	0	0
a.	Detyrim ndaj Wonder sha kontrate sipermarrje 17.000 euro				2 102 951	-1 450 920						-727 690			
b.	Detyrim ndaj Stavri Prifti 30.000 euro				3 711 090										
c.	Hua nga BKT per makinën Volkswagen Tiguan (kredi e padeklaruar)						380 000								
d.	Principal i kredise se makines (BKT 2008)						-379 999								
3	PASURI NETO (1-2)	700 000	0	435 872	7 193 133	2 586 484	3 441 925	2 311 142	4 478 159	1 803 869	3 808 901	4 897 923	2 193 643	1 856 251	2 481 223
4	TË ARDHURA	632 634	872 853	800 242	7 600 726	1 786 045	2 842 721	3 492 433	4 795 309	4 039 594	4 766 237	5 852 001	5 812 042	6 476 191	7 226 022
a.	Te ardhura nga pagat e subjektit	632 634	872 853	793 562	706 924	829 450	968 906	1 039 625	1 064 724	1 124 682	1 013 322	1 163 741	1 250 550	906 927	1 222 913
b.	Te ardhura nga pagat BSH Fakulteti Gjuheve te Huaja				575 453	611 084	710 271	675 593	797 093	831 771	835 141	875 920	870 095	886 150	849 291
c.	Te ardhura nga GTZ-GIZ Shqip. & Mal I zi				0	28 537	478 588	1 128 872	576 843	0	1 284 186	2 189 342	2 380 939	2 625 913	2 683 380
d.	Te ardhura nga KE					214 857	35 846	124 825	259 019						
e.	Te ardhura Friedrich Hebert												0		223 975
f.	Te ardhura Kontrolli i Larte i Shtetit							20 475							
g.	Te ardhura nga Ministria e Drejtesise				18 720		289 837	63 405	125 784	150 468	6 570	60 912	258 297	387 735	677 533
h.	Te ardhura nga Agjensia e Sherbimi Arkeologjik						52 370								
i.	Te ardhura nga Ministria e Shendetesise						40 157								
j.	Te ardhura per perkthime nga institucione te ndryshme				10 000	74 000	136 170	247 158	944 347	651 739	820 504	563 074	360 531		113 441
m.	Agjensia Kombetare e Turizmit						30 420								
q.	Te ardhura nga Conrad Adenauer							27 434	823 282	793 565	167 245				
	E ardhur nga bsh per apartamentin				6 289 629										
	Te ardhura nga interesat bankare			6 680	0	28 117	100 156	165 046	204 217	487 369	639 270	999 012	691 630	1 669 466	1 455 489
5	SHPENZIME	137 964	137 964	239 335	981 863	598 347	451 859	1 144 794	679 017	1 066 793	867 997	762 260	1 153 910	1 247 207	1 702 230
a.	Interes hua BKT						35 124								
b.	Shpenzime shkollii Soniel										26 800	68 200	70 800	73 200	75 400
c.	Shpenzime shkollii Nikol													30 000	75 400
d.	Shpenzime udhetimi ne funksion te detyres	44 000	44 000	44 000		44 000		44 000	44 000	44 000	44 000	58 000	66 000	18 000	
e.	Shpenzim arredimi per gjithe periudhen pas martese te ndare ne tre vite				600 000			300 000		300 000					
f.	Shpenzime jetese	93 964	93 964	109 557	328 671	409 860	409 860	546 480	546 480	546 480	558 192	564 096	879 992	1 121 380	1 175 460
g.	Shpenzime udhetimi			85 778	53 192	144 487	6 875	254 314	88 537	176 313	239 005	71 964	137 118	4 627	375 970
	DIFERENCA (TË ARDHURA -PASURI-SHPENZIME 4-3-5)	-205 330	734 889	125 035	-574 271	-1 398 786	-1 051 063	36 498	-361 867	1 168 932	89 340	191 819	2 464 488	3 372 733	3 042 570

Konkluzione për rubrikën e vlerësimit të pasurisë

15. Në përfundim, Komisioni, pasi shqyrtoi çështjen dhe vlerësoi shpjegimet e subjektit pas dërgimit të barrës së provës, arriti në përfundimin se subjekti i rivlerësimit, znj. Fjoralba Prifti, nuk ka arritur një nivel të besueshëm të vlerësimit të pasurisë.

16. Nëpërmjet procedurës së kontrollit të pasurive, synohet identifikimi i atyre subjekteve të rivlerësimit, të cilët janë bërë përfitues apo përdorues të pasurive në mënyrë të paligjshme apo me të ardhura, ligjshmëria e të cilave, referuar standardit të përcaktuar në pikën 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës, vihet në dyshim, pavarësisht nëse ky fakt nuk lidhet në mënyrë të drejtpërdrejtë me ushtrimin e detyrës së subjektit apo rezulton të ketë ndodhur jashtë periudhës kohore të ushtrimit të saj. Konfirmimi i një marrëdhënieje të tillë të magjistratit në raport me ligjin, qoftë në formën e veprimeve të saj në kundërshtim me ligjin apo edhe në formën e pranimin të veprimeve të personave të lidhur me të, cenon vlerat themelore të tij, si rrjedhojë, edhe besimin që ai duhet të përcjellë te publiku në përmbushjen e misionit/rolit në dhënien e drejtësisë.

17. Për rrjedhojë, nga vlerësimi i përgjithshëm i pasurisë së subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur me të, trupi gjykues çmon se subjekti i rivlerësimit gjendet në kushtet e parashikuara nga geramat “b”, “c” dhe “ç”, e pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016, të cilat të vlerësuara së bashku, të çojnë në konkluzionin se duhet zbatuar pika 3, e nenit 61, të ligjit nr. 84/2016, i cili e vë atë në kushtet e një deklarimi të pamjaftueshëm, si një shkak ligjor për zbatimin ndaj saj të masës disiplinore të shkarkimit nga detyra.

B. VLERËSIMI I FIGURËS

18. Drejtoria e Sigurisë së Informacionit të Klasifikuar (DSIK) ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikonte nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016.

DSIK-ja ka dërguar raportin mbi kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, më 14.2.2018 në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, ku ka konstatuar përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit Fjoralba Prifti. Më tej, raporti është deklasifikuar plotësisht me vendimin nr. ***, datë 24.1.2019, të KDZh-së.

19. Komisioni i kërkoi informacion Prokurorisë së Përgjithshme mbi të dhëna ose *indicie* nga agjencitë ligjzbatuese për fillimin e hetimeve në lidhje me dyshimet e ngritura në kuptimin penal dhe atë të cenimit të figurës së subjektit të rivlerësimit, të përfshirë drejtpërdrejtë në veprime të dyshimta, si dhe informacione mbi kontakte të papërshtatshme.

20. Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, me shkresën nr. *** prot., datë 19.7.2019, informoi se nga verifikimi i kryer në regjistrin elektronik të kallëzimeve penale dhe procedimeve penale, për periudhën kohore 1.1.2006 – 19.7.2019, rezultoi se ndaj subjektit të rivlerësimit në vitin 2016 është regjistruar kallëzimi penal nr. ***, për “shpërdorim detyre”, për të cilin është vendosur mosfillimi i procedimit penal për kallëzimin e kryer.

21. Prokuroria pranë Gjykatave të Shkallëve të Para nëpër rrethe të tjera informojnë ndër të tjera se, ndaj subjektit nuk rezultojnë të jenë regjistruar kallëzime, procedime penale apo disiplinore në ngarkim të saj.

22. Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, me shkresën nr. ***prot., datë 9.10.2019, informon se në datën 9.5.2019 është regjistruar kallëzimi penal nr. ***, në lidhje me veprën penale “korrupsion pasiv i gjyqtarëve, prokurorëve dhe funksionarëve të tjerë të organeve të drejtësisë”, parashikuar nga neni 319/ç i Kodit Penal. Pas verifikimeve të kryera,

më 23.5.2019, prokurori i çështjes ka vendosur të mosfillojë çështjen. Kjo çështje është vlerësuar te rubrika e vlerësimit profesional.

Konkluzione për rubrikën e vlerësimit të figurës

23. Nga informacioni i administruar në Komision, gjatë hetimit nuk u gjet element që të vërtetojë ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës.

24. Trupi gjykues i Komisionit vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaram të saktë në lidhje me kriterin e kontrollit të figurës. Konstatimet e gjetura gjatë hetimit mund të vlerësohen në raport me vlerësimin profesional apo në vlerësimin në tërësi të çështjes, të subjektit të rivlerësimit znj. Fjoralba Prifti, brenda përcaktimeve të ligjit nr. 84/2016.

C. VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE

25. Ky raport profesional është përgatitur bazuar në raportin e sjellë nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, në denoncimet e paraqitura, si dhe në gjetjet e evidentuara nga Komisioni gjatë hetimit administrativ.

26. Nga vlerësimi i përgjithshëm i dosjeve të vlerësuara nga Këshilli i Lartë Gjyqësor ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit, znj. Fjoralba Prifti, vlerësohet e aftë në drejtim të interpretimit dhe zbatimit të ligjit. Ajo ka aftësi në arsyetimin ligjor të vendimeve, duke respektuar rregullat e drejtshkrimit dhe duke përdorur rregullisht të gjitha karakteret e gjuhës shqipe. Në përgjithësi, struktura e vendimeve përfundimtare është e standardizuar dhe respekton kërkesat e legjislacionit procedural administrativ, civil dhe penal. Nga ana tjetër është konstatuar se në dispozitivin e vendimit, në 4 nga rastet e vëzhguara, subjekti nuk shprehet në lidhje me shpenzimet gjyqësore, si dhe nuk përcaktohet e drejta e rekursit për palët. Përfundim tërësor në dosja 5, ku është shprehur vetëm për shpenzimet gjyqësore.

27. Lidhur me këto konstatime, subjekti i rivlerësimit është shprehur se duke konfirmuar vendimin e gjykatës së shkallës së parë nëpërmjet lënies në fuqi të tij, ka disponuar njëkohësisht edhe për shpenzimet gjyqësore, duke bërë që vendimi objekt ankimi i gjykatës së shkallës së parë të përbëjë titull ekzekutiv në kuptim të ligjit.

27.1 Në asnjë nga dosjet nuk rezulton që shkak ankimi të ketë qenë mënyra e caktimit të shpenzimeve gjyqësore nga gjykata e shkallës së parë dhe, për pasojë, mospasqyrimi në dispozitivin e vendimit të gjykatës së apelit, se cilës palë i ngarkohen shpenzimet gjyqësore nuk përbën mosrespektim të kërkesave formale të vendimit gjyqësor të gjykatës së apelit apo gjykatës administrative të apelit.

27.2 Në lidhje me mosshpjegimin e së drejtës së rekursit në vendimet e dhëna në cilësinë e gjyqtares së Apelit Shkodër, subjekti thekson se kjo ka qenë një praktikë në këtë gjykatë, praktikë, sipas së cilës pasqyroheshin në dispozitiv me korrektësi kërkesat e nenit 466 të Kodit të Procedurës Civile me titull “vendim i gjykatës së apelit”, në të cilin përcaktohet mënyra e disponimit të gjykatës së apelit.

27.3 Mospasqyrimi i së drejtës së rekursit dhe afatit të tij, në asnjë rast, nuk rezulton se ka shkaktuar humbjen e së drejtës dhe afatin e ankimit, të cilët janë parashikuar në ligj, dijenia e të cilit prezumohet për palët.

28. Në përfundim, evidentohet se subjekti i rivlerësimit ka pasur ngarkesë të lartë sasiore në Gjykatën e Apelit Shkodër. Ajo nuk ka pasur vonesa në gjykimin e çështjeve që i janë caktuar, por ka pasur vonesa në arsyetimin dhe dorëzimin në sekretari të vendimeve gjyqësore (shihni dosjet 1, 3, 4 dhe 5).

29. Sipas të dhënave nga regjistri i ankesave rezultojnë se gjatë periudhës trevjeçare të rivlerësimit (8 tetor 2013 – 8 tetor 2016) për gjyqtaren Fjoralba Prifti janë paraqitur dy ankesa në Inspektoratin e KLD-së (1 në vitin 2014 dhe 1 ankesë në vitin 2016). Sa i përket ankesës së vitit 2014, është verifikuar për “zvarritje gjykimi” dhe është arkivuar pasi pretendimet ishin të pabazuara. Ndërsa, ankesa e vitit 2016 është arkivuar pas shqyrtimit fillestar me arsyetimin se pretendimet mund të zgjidhen përmes apelimit gjyqësor.

30. Në Komision janë paraqitur 21 denoncime për subjektin e rivlerësimit, znj. Fjoralba Prifti, për të cilat janë kërkuar dosjet në disa raste si dhe shpjegime nga subjekti i rivlerësimit. Në shpjegimet e saj subjekti ka arsyetuar se *denoncimet për korrupsion e kanë burimin në pakënaqësinë e palës ndaj vendimit të dhënë nga gjykata dhe në asnjë rast nuk ka lidhje me veprimet e saj si gjyqtare, e ngarkuar me shqyrtimin e çështjes. Sipas aneksit “E”.2 të Kushtetutës përcaktohet se: “Vlerësimi i aftësisë për gjyqtarët, këshilltarët ligjorë ose ndihmësit ligjorë përfshin aftësinë për të gjykuar, aftësitë organizative, etikën dhe angazhimin ndaj vlerave gjyqësore, cilësitë personale dhe angazhimin profesional, bazuar në standardet e parashikuara në ligj.”*

Në këto rrethana drejtësia e vendimit dhe bazueshmëria e tij në prova dhe në ligj është objekt shqyrtimi sipas ligjit nga Gjykata e Lartë.

Subjekti ka shpjeguar se ankesat për zvarritje procesi nuk janë të bazuara pasi është një fakt i njohur tashmë, edhe për Komisionin se shteti shqiptar nuk garanton për qytetarët e tij zbatimin e detyrimit ligjor të përcaktuar në nenin 48⁵⁸ të ligjit nr. 49/2012, për shqyrtimin e çështjes së tyre në Apel brenda 30 ditëve nga dita e ardhjes së ankimit për shkak se nuk ka përdorur mekanizmat e duhur që mundësojnë praktikisht zbatimin e normës. Ajo thekson se një ndër shkaqet e vonës në trajtimin e çështjeve ka të bëjë edhe me mënyrën e organizimit të brendshëm të gjykatës, sipas të cilit disa gjyqtarë ngarkohen me më shumë çështje, e disa të tjerë më pak, ndryshimin e shpeshtë të trupave gjykues, mungesën e rekrutimit të një stafi të përshtatshëm me ndihmës ligjorë.

31. Lidhur me një denoncim për subjektin e rivlerësimit nga disa juristë - denoncim që përfshin shumë subjekte rivlerësimi dhe pretendohet për veprime të jashtëligjshme dhe veprimtari korruptive në sistemin e drejtësisë. Denoncuesit denoncojnë një grup subjektësh rivlerësimi, ndër ta edhe gjyqtaren Fjoralba Prifti, për të cilën pretendojnë se së bashku me trupën që gjykon, kanë prioritet të tyre në këtë periudhë shqyrtimin e çështjeve të përshpejtuara. Kjo gjyqtare në bashkëpunim me z. A. Q. janë kthyer në “sh.p.k” në Gjykatën Administrative të Apelit.

Vendimet abuzive që ka dhënë subjekti i rivlerësimit janë:

1) Vendimi i datës 31.1.2017, me anë të të cilit subjekti Fjoralba Prifti me anëtarin A. M. dhe gjyqtaren e shkallës së parë, që kishte gjykuar këtë çështje, shoqen e tyre të klasës në magjistraturë G. M. (e cila ka mundur negociim për të mundur ndryshimin e vendimit), ka vendosur haptazi në kundërshtim me ligjin.

2) Në kundërshtim me ligjin, subjekti ka vendosur përshpejtimin e çështjes me nr.***, datë 15.5.2018 (ndërkohë që çështjet në radhë për t’u gjykuar prej saj janë ato me datë regjistrimi qershor-korrik 2016), me palë paditëse shoqërinë “***” sh.p.k. Av. V. H. ka negociuar nëpërmjet gjyqtarit A. Q. që kjo gjyqtare të përshpejtojë çështjen dhe të japë një vendim në favor të shoqërisë paditëse.

3) Subjekti Fjoralba Prifti ka gjykuar gjithashtu çështjen me palë paditëse “D. O” dhe të paditur “D M.”, çështje për të cilat janë cenuar rëndë interesat pasurore të shtetit.

⁵⁸ Neni 48/2 i ligjit nr. 49/2012 përcakton se: “Gjykata Administrative e Apelit shqyrton çështjen brenda 30 ditëve nga data e ardhjes së ankimit nga gjykata ku është paraqitur ankimi. “

Lidhur me çështjen me palë paditëse “****” dhe të paditur “***referuar edhe *indicies* së ardhur në Komision dhe dosjes së administruar nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë me shkresën nr. ***, datë 9.10.2019 informon se në datën 9.5.2019 është regjistruar kallëzimi penal nr. ***, në lidhje me veprën penale “korrupsion pasiv i gjyqtarëve, prokurorëve dhe funksionarëve të tjerë të organeve të drejtësisë”, parashikuar nga neni 319/ç i Kodit Penal. Pas verifikimeve të kryera, në datën 23.5.2019, prokurori i çështjes ka vendosur të mosfillojë çështjen.

Kjo çështje lidhet me gjykimin nga subjekti të çështjes me palë paditëse “****” dhe të paditur “****”, një nga çështjet e referuara në denoncim nga një grup juristësh.

Komisioni, më herët, ka kërkuar dosjen që i përket çështjes administrative me palë paditëse kompaninë e hidrokarbureve “****” sh.a., palë të paditur Drejtoria Rajonale Tatimore e Tatimpaguesve të Mëdhenj, Tiranë dhe Drejtoria e Apelit Tatimor, Tiranë me objekt: (i) konstatimi i pavlefshmërisë absolute të akteve administrative, njoftim vlerësim tatimor nr. ***, datë 11.8.2015, të Drejtorisë Rajonale Tatimore të Tatimpaguesve të Mëdhenj, Tiranë dhe vendimit nr. ***, datë 27.10.2015, të Drejtorisë së Apelit Tatimor Tiranë; (ii) pezullimin e zbatimit të aktit administrativ, njoftim vlerësimi tatimor nr. ***, datë 11.8.2015, të Drejtorisë Rajonale Tatimore të Tatimpaguesve të Mëdhenj Tiranë, bazuar në nenet 115, 116, 117/2 e në vijim të Kodit të Procedurave Administrative, si dhe ligjeve përkatëse në fushën tatimore.

➤ **Pas administrimit të akteve të dosjes gjyqësore, nga verifikimi i tyre konstatohet si vijon:**

1) Në tërësi, rrethanat e çështjes deri në ushtrimin e veprimtarisë së organit tatimor janë fokusuar në ushtrimin e kontrollit tatimor, që i është bërë palës paditëse, sa i përket kryesisht tatimit mbi vlerën e shtuar, tatim-fitimit, sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, si dhe taksës kombëtare nga ku pala paditëse “****” sh.a. ka rezultuar me detyrime tatimore të papaguara. DRTTM-ja Tiranë ka konkluduar pas kontrollit të njoftuar dhe të ushtruar pranë palës paditëse, me “njoftim vlerësimin” objekt i këtij procesi gjyqësor, sipas të cilit pala paditëse detyrohej të paguante detyrimet e papaguara.

2) Më tej, mbi ankimin e palës paditëse, Drejtoria e Apelit Tatimor ka rezultuar në vendimmarrjen e saj nr. ***, datë 27.10.2015 (objekt ankimi në gjyqësor) mbi rrëzimin e ankimit. Ndër të tjera, organi i lartë administrativ (Apeli Tatimor) ka arsyetuar se kompania e rezultuar në detyrime tatimore të pashlyera, nuk ka përmbushur në ankim kërkesat ligjore për të paguar detyrimin tatimor të rezultuar sipas “njoftim vlerësimi tatimor” apo për të vënë garancinë e kërkuar me qëllim vijimin e shqyrtimit të ankimit si kushte detyruese për t’u vijuar me shqyrtimin e ankimit.

3) Çështja është bërë objekt i gjykimit administrativ në gjyqësor.

4) Rezulton se çështja gjyqësore është regjistruar në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, në datën 24.11.2015, me nr.*** Akti dhe ka përfunduar në datën 30.11.2016.

5) Paraprakisht, mbi kërkesën e palës paditëse me vendimin datë 1.12.2015 është vendosur “Sigurimi i padisë”.

6) Me vendimin nr. ***, datë 30.11.2016, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë ka vendosur rrëzimin e padisë së shoqërisë “****” sh.a, si të pabazuar në ligj e në prova.

7) Mbi ankimin e palës paditëse, çështja është gjykuar në Gjykatën Administrative të Apelit. Çështja është regjistruar në datën 13.3.2017 dhe ka përfunduar me vendimin nr. ***, datë 6.7.2017, sipas të cilit kjo gjykatë ka vendosur ndryshimin e vendimit të gjykatës së shkallës së parë; konstatimin e pavlefshmërisë absolute të njoftim vlerësimi tatimor nr. ***, datë 11.8.2015 të DRTTM-së Tiranë dhe vendimit nr. ***, datë 27.10.2015, të Drejtorisë së Apelit Tatimor Tiranë.

8) Në arsyetimin e bërë, kjo gjykatë ka argumentuar faktin se: (i) akti i njoftimit të vlerësimit për detyrimet tatimore nuk është nxjerrë nga organi kompetent, pasi është nënshkruar nga një punonjës i palës së paditur/punonjës i administratës tatimore dhe se cilësimi “me porosi” të drejtorit të institucionit tregon se akti është nxjerrë në kushtet e delegimit të kompetencave; (ii) raporti përfundimtar i kontrollit tatimor, datë 7.8.2015, pavarësisht se është nënshkruar nga të gjithë pjestarët e grupit të kontrollit, nuk është miratuar nga urdhëruesi i kontrollit (shihni nenin 80/5 të ligjit nr. 9920/2008, i ndryshuar).

9) Ndaj këtij vendimi është ushtruar rekurs në Gjykatën e Lartë nga DRTTM-ja Tiranë, si dhe Avokatura e Shtetit.

10) Me shkresën datë 8.2.2018, gjykata administrative e shkallës së parë ka dërguar në Gjykatën e Lartë dosjen gjyqësore, e cila deri aktualisht nuk ka përfunduar së shqyrtuari.

11) Në konkluzion të verifikimit të të gjithë dokumentacionit të pasqyruar më sipër, konstatohet se:

- Çështja në Gjykatën Administrative të Apelit është gjykuar brenda 4 muajve nga regjistrimi i saj dhe subjekti i rivlerësimit ka qenë relatorja e kësaj çështjeje. Komisioni i ka kërkuar subjektit të rivlerësimit shpjegime lidhur me:

a) Pse e gjykuat ju këtë çështje kaq shpejt, cilat ishin shkaqet?

b) A kishit ju çështje të tjera të kësaj natyre në proces dhe cila është ecuria e tyre?

c) Sa çështje keni trajtuar ju me procedurë të përshpejtuar, që prej vitit 2019 deri më sot?

- Në aktet e administruara nuk rezulton kërkesë për ndjekjen e procedurës së përshpejtuar. Nëse ka një të tillë, përse ajo nuk ka qenë e përshirë në dosje? Sa kërkesa keni pasur për trajtimin e çështjeve me procedurë të përshpejtuar në harkun kohor 2017-2018 dhe sa prej tyre keni pranuar, në cilësinë e relatores.

32. Në shpjegimet e saj lidhur me këtë çështje subjekti ka shpjeguar se: *“... të dhënat e shpalljeve, të gjykimeve të planifikuara nga ana ime në periudhën 2019-2020, tregojnë se është respektuar radha e gjykimit, ndërkohë që çështjet e trajtuara në mënyrë të përshjetuar janë kryer në përputhje me vendim nr. 78, datë 30.5.2019, “Për kalendarin e shqyrtimit të çështjeve në gjykatën e apelit” dhe kanë pasur si prioritet trajtimin e çështjeve të personave në nevojë (konflikte pensioni, konflikte pune, invaliditeti), trajtimin e çështjeve në të cilat palët janë në konflikt për periudha afatgjata, trajtimin e çështjeve ku institucionet shtetërore kanë kërkuar zgjidhjen e tyre me prioritet).*

*Pavarësisht se me shkresën nr. *** prot., datë 25.8.2020, kryetari i Gjykatës Administrative të Apelit ka sqaruar se Gjkata Administrative e Apelit nuk disponon kërkesat për përshpejtim të pranuar nga ana ime, pasi ato janë bërë pjesë e dosjes së përshpejtuar, për dosjet të cilat janë ende në proces shqyrtimi në Gjykatën Administrative të Apelit, për të cilat unë kam proceduar me pranimin e kërkesave për përshpejtim, bashkëngjitur këtyre shpjegimeve do të gjeni edhe vendimet e mia për pranimin e kërkesës për përshpejtim, si dhe kërkesat për përshpejtim të paraqitura nga palët.*

Për dosjet e tjera jam në pamundësi objektive për të identifikuar çdo çështje të përshpejtuar për shkak se dosjet pas shqyrtimit në apel ose janë përcjellë në Gjykatat e Shkallëve të Para respektive për rigjykim, ose arkivim, ose janë përcjellë Gjykatës së Lartë për shqyrtimin e rekurseve.

Bashkëngjitur shpjegimeve subjekti ka përcjellë edhe listën e shpalljeve të çështjeve të planifikuara për gjykim për vitin 2019 dhe deri qershor 2020.

33. Gjatë hetimit nuk rezultuan të dhëna, të cilat të ngrenë dyshime të arsyeshme mbi veprime korruptive të kryera nga subjekti i rivlerësimit apo në bashkëpunim me persona të tjerë. Në

përfundim, Komisioni vlerëson se të dhënat e evidentuara nga kjo dosje, nuk janë të tilla që të konsiderohen në vlerësimin profesional të subjektit të rivlerësimit.

34. Në një vlerësim të përgjithshëm të denoncimeve dhe shpjegimeve të subjektit të rivlerësimit në raport me to, si dhe dokumentacionit të administruar në këtë kuadër, Komisioni çmon se në vlerësimin e përgjithshëm nuk janë konstatuar gabime thelbësore dhe serioze apo një seri e qartë dhe e vazhdueshme e gjyqimeve të gabuara prej saj, e cila mund të çonte në një mungesë të aftësive profesionale.

Konkluzione për rubrikën e vlerësimit profesional

35. Trupi gjykues vlerëson se në bazë të të gjitha rrethanave dhe kushteve të mësipërme, subjekti i rivlerësimit ka nivelin kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, të kërkuar nga ligji nr. 84/2016.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 2, të nenit 4, germën “c”, pika 1, të nenit 58, si dhe në pikën 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, pasi konstatoi se subjekti nuk ka arritur një nivel të besueshëm të vlerësimit të pasurisë dhe duke e vlerësuar këtë kriter si të mjaftueshëm për vlerësimin përfundimtar të subjektit të rivlerësimit,

VENDOSI:

1. Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, znj. Fjoralba Prifti, gjyqtare në Gjykatën Administrative të Apelit.
2. Ky vendim, i arsyetuar me shkrim, i njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim mund të ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të vendimit.
4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.

Ky vendim u shpall në Tiranë, në datën 17.9.2020.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Pamela QIRKO
Kryesuese

Valbona SANXHAKTARI
Relatore

Lulzim HAMITAJ
Anëtar

Sekretare gjyqësore
Orjanda Lici